

KOSOVARJA

Ballina: Mirlinda Nuhiji

**Presidentja
jonë
ma qon mallin
e hallës teme**

**Si u dogjën Drita
dhe Fexhrije Musa
mbi urën e Lluzhanit**

**Zhgënjimi dhe gëzimi
i një gazetari kosovar
në Shqipëri**

**Cili ishte
amaneti
i Bekim
Fehmiut
për Uliksin**

**Trupshkurtat
tona që e kallin
skenën**

**Sa herë
është martuar
e ndarë
Big Mama**

**Njerëzit
po e njohkan
gruan time
më mirë se unë**

MIRLINDA NUHIJI

*më e kërkuara në Zvicër
për mbjelljen e qerpikëve*

remos

MOLLA

a.g.e.stop
SWITZERLAND

CHE

BREZOVICA

CIMA

UB
UNION BUSINESS
ALBANISCH & DEUTSCH

DINO
CERAMICHE

Shkabaj

DENTFIX

Shkenderi Dëshmor

SHERWOOD

AS

allure

BETON




HOTELERI



DINO COMPANY

NDËRTIM



QERAMIKË



GURTHYES

📍 Magjistrallja Prishtinë - Ferizaj
🏠 Fsh. Konjuh 14000 Lipjan, Kosovë

📞 + 383 44 206 586
🌐 www.dino-5.com

Mirlinda Nuhiji është profesionistja numër një në Zvicër, në fushën e mbjelljes së qerpikëve. Ajo është kampione e shpallur e këtij profesioni, të cilin e punon me shumë passion e dashuri. E certifikuar dhe dëshmuar denjësisht, Linda me cilësi superiore ia ka dalë që punën e saj ta bëjë të njohur gjerësisht.

“Linda Lashes” në Zvicër është adresa kryesore për femrat që duan të kenë qerpikë voluminoz dhe me pamje perfekt.

Përtej sukseseve në profesion, Mirlinda është një zonjë që shkëlqen: e pashme, e përkushtuar ndaj familjes dhe grua e lindur për biznes.

Në ballinë

Mirlinda Nuhiji

më e kërkuara në Zvicër
për mbjelljen e qerpikëve



Si duhet ta njohim ne dhe publiku më mirë Mirlinda Nuhijin?

- Jam 29 vjeçe, nga Tetova, por e martuar në Gjilan. Jam nënë e tri vajzave dhe bashkë me familje jetoj në Zvicër. Ndihej e plotësuar në aspektin profesional dhe atë privat.

Cilat ishin ëndrrat tua dikur?

- Si të gjitha femrat e tjera, ëndrra ime ishte të isha e pavarur. Kisha edhe shumë ëndrra të tjera, por rruga deri te realizimi dukej e gjatë. Kur mblodha vetëbesimin, arrita t'i realizoj të gjitha ambiciet dhe ëndrrat e mija të dikurshme.

A ke menduar se një ditë do të jesh kjo që je sot?

- Nëse flasë drejt, pranoj që nuk kam menduar as ëndërruar se do jem kjo që jam sot...

Njihesh si femër e fortë në profesion dhe biznes. Si ia dole të jesh Mirlinda që je sot?

- Falë faktit që kam qenë gjithmonë vetja, jam përkushtuar shumë në synimet e mija dhe në ngritjen time profesionale. Nuk i kam ndjekur rregullat e profesionit, kam pasur stilin tim unik në profesion dhe marketing. Jam përpjekur shumë që të jem korrekte dhe të kem komunikim sa më të mirë.

Ku je shkolluar ose trajnuar për punën që bën?

- Në fillim jam trajnuar në Zvicër dhe, pasi i kam kaluar të gjitha nivelet, kam nisur me trajnime profesionale në Moskë.

Ju jeni profesionistja më e njohur për qerpikë në Zvicër, madje jeni edhe kampione. Si u bërë e tillë?

- Çdo gjë arrihet me punë dhe përkushtim. Jam angazhuar në profesion me tërë qenien dhe e kam lënë punën të flasë në emrin tim. Dhe, jam kualifikuar si kampione e Zvicrës për vitin 2020.

Me çfarë teknikash punoni dhe cili është shërbimi më i veçantë që ofroni?

- Punoj me teknikën "Russian Volume", që është mahnitëse dhe shërbimi më i veçantë te unë - qerpiku me ngjyra, por edhe gjatësia maksimale. Gjithashtu, mbaj edhe master class dhe deri më tani gjithçka shkon shkëlqyeshëm.

Kush është klientela juaj dhe a ka edhe femra të njohura e të suksesshme?

- Janë femra të ndryshme që duan të duken bukur: gra të zakonshme, por edhe të suksesshme e të famshme. Klientja më e njohur e shou-bizit është Era Istrefi, por edhe të tjera. Bashkëpunoj me hotele luksoze të Zvicrës dhe kujdesem për pamjen e klienteles VIP që ata kanë, por me marrëveshje emrat dhe detajet mbetën sekret.

Cila është kërkesa më e shpeshtë e femrave që vijnë në sallonin tuaj për qerpikë?

- Femrat duan që qerpikët e tyre të duken sa më bukur, sa më natyral, të shëndetshëm dhe voluminoz. Dhe, ne këtë gjë dimë ta bëjmë shumë mirë. Kërkesa më e madhe është për teknikën "Russian Volume", që në "Linda Lashes" ofrohet në mënyrë ekskluzive.

A i keni produktet tuaja të personalizuar?

- Po, kam produkte të personalizuar. Në fakt, të gjitha produktet, me të cilat punoj, janë të mijat dhe ato janë të një kualiteti e cilësie superiore.

A i shisni produktet tuaja?

- Po. Sallonet më të njohura blejnë dhe punojnë me produktet e mia, "Linda Lashes", të cilat mund të porositen në www.linda-lashes.ch/shop

A keni plane që të jeni edhe në Kosovë?

- Aktualisht jo. Sepse, pandemia e ka ngadalësuar zhvillimin e



çdo biznesi. Andaj, është vështirë të menaxhohen dy sallone, në dy vende të ndryshme, në këtë kohë pandemie. Por, edhe për mua vlen thënia: Kurrë mos thuaj kurrë!

Ku e gjeni forcën për të punuar dhe për të qenë kjo që je?

- Forcën e kam nga i madhi Zot, i cili më mundëson të punoj me pasion e pa u ndalur.

Personi që u motivon?

- Pa dyshim, motivin e gjej te familja dhe fëmijët e mi.

Të jesh nënë, profesioniste dhe grua në biznes, sa sfiduese është?

- Është mjaft sfiduese, por duhet të dish të mbash balancën. Unë punën e bëj me zemër e dëshirë, andaj kjo e lehtëson, edhe pse ta kesh një biznes të suksesshëm, ndërkohë që je nënë e tre fëmijëve dhe duhet t'i përkushtohesh familjes, nganjëherë bëhet mjaft sfiduese.

Dukeni shumë bukur. Sa investoni në vete?

- Po, dukem bukur, sepse dua të jem imazh i mirë. Dua të jem shembull për femrat shqiptare, të cilat, sipas meje, janë më të bukurat në botë. E, secila femër duhet t'i përkushtohet vetes...

Personi ose gjëja pa të cilën nuk e mendoni jetën?

- Jetën nuk mund ta mendoj pa fëmijët dhe familjen time.

Porosia juaj për femrat?

- Mos u ndalni asnjëherë në rrugën e realizimit personal!

N. Neziri



"Presidentja jonë ma qon mallin e hallës teme!"

Pakënaqësi në popull ka pasur dhe do të ketë gjithmonë, sepse keqpërdorimet, hajnitë me tenderë të ndryshëm, shfrytëzimi i pasurisë publike dhe të tjera të ngjashme, përherë janë aktuale në Kosovë.

Konkretisht, për këtë temë, flasim të anketuarit tanë...

HIDAJET AZEMI, GJILAN: PARTITË PUNOJNË PËR INTERES PERSONAL

- Jam i bindur se asnjë lider dhe parti që veprojnë momentalisht në Kosovë nuk e vënë në rend të parë qytetarin, pastaj veten. Të gjithë liderët e partive i shikojnë interesat personale dhe partiake. Vetëm në fushata zgjedhore u bie në mend për ekzistencën e popullit, kurse që nga momenti kur ulen në kolltuk as që të njohin më...

Akuzat, përplasjet, intrigat kundër njëritjetrit, i bëjnë për përfitime partiake, e jo në interes të popullit.

Presidentja jonë ma qon mallin e hallës teme, e cila, sa herë që vjen, ka dëshirë të flasë për të kaluarën tonë familjare...

RASIM SELMANI, FERIZAJ: PËR MUA RAMUSHI ËSHTË I LINDUR PËR POLITIKË

- Ne, populli i Kosovës, disa herë dolëm në zgjedhje, ua dhamë votën politikanëve

tanë, ua dhamë besimin, forcën, shtytjen për t'i zënë pozitat e dëshiruara, kuptohet në mbështetje të premtimeve të shumta gjatë fushatës zgjedhore.

Por, cili prej tyre i mbajti premtimet?

Unë përkrah vetëm politikën e Ramush Haradinajt. Ai është i lindur për politikë. Ka mënyrë tjetër të qeverisjes në kokë, në krahasim me politikanët tjerë që i ka Kosova...

SELIME GASHI, PEJË: JEMI NGOPUR ME PREMTIME BOSHE!

- Me premtime boshe jemi ngopur. Vetëm Lëvizja "Vetëvendosje" besoj se flet siç duhet. Kanë ide të qarta, transparente. Por, edhe për ta është herët të flitet...

GANI RUHANI, MITROVICË: DUHET TË NDRYSHOJË SHUMËÇKA!

- Vendi, shoqëria, sistemi qeverisës te ne, në Kosovë, duhet të ndryshojnë rrënjësisht, e këtë mund ta bëjnë vetëm njerëzit

me vlerë dhe etikë, të tillët që kanë moral. Andaj, të tillët, të punojnë më tepër në dobi të popullit, në mënyrë që të mburremi me ta.

SAMAUDIN GASHI, RAHOVEC: SECILA PARTI PUNON PËR INTERESA TË VETA!

- Politikanët tanë, e që e kanë timonin në dorë, e drejtojnë kah interesat e veta: për t'i arritur synimet e tyre, për të mos humbur pasurinë që kanë...

Maje, ka të tillë që janë në gjendje të bëjnë pakt edhe me dreqin e mallkuar, vetëm e vetëm për të arritur qëllimin e tyre...

VEHADIN ISENI, PRISHTINË: MJERË PENSIONISTËT!

- Unë, si pensionist, nuk jam fare i kënaqur me shumën e pensionit që marr. Pensioni im nuk m'i plotëson as për së afërmi nevojat e mia personale, e lëre më shumë...

Andaj, lus politikanët që janë në pushtet, të mendojnë edhe për ne, pensionistët, e që kemi mbetur në mëshirën e kohës...

Diturie Haxhaj



Dialog në çajtores...

RROFTË AMERIKA!

I DYT: Ncnc-ncnc...

I KATËRTI: Po, çka ndodhi bre, çka u bë?!

I DYT: Po qysh bre çka u bë? Nuk është mahi me shqiptarë, a?! Shumë të parhatshëm, shumë të çuditshëm, shumë interesantë...

I TRETI: E pse, vëlla? Po na trego tash se m'plase!

I DYT: Po ju, a përcillni ndonjë lajm në televizor a portal, ore?!

I TRETI: Po ti, na trego për çka e ke fjalën?

I DYT: Po qysh bre, këta vëllazëria e Shqipërisë, sa herë Kosova i ka punët ngushtë a ndonjë problem, ata sikur me qëllim çohen e bëjnë tollovi!

I KATËRTI: Qe besa, hiç keq s'e ke. A u kujtohet se edhe sa ishim ndër këmbët e shkaut, derisa për ne kosovarët pritej të vendosej diçka në çarqet ndërkombëtare, atje, në Shqipëri, bëhej diçka që, pastaj, vëmendja e ndërkombëtarëve përqendrohej andej...

I PARI: Qashtu ndodhi edhe atëherë, më '97, me revolucionin e vonuar të Rexhep Qosjes, që jo vetëm në Shqipëri, por edhe neve në Kosovë na dëmtoi shumë... Aq më shumë shkau e shtoi zullumin ndaj nesh...

I TRETI: O Zot, krejt n'rregull, por sot pse ky muhabet?!

I DYT: A e dëgjove lajmin për Salih Berishën? O Zot, merre me mend, Berisha korruptuesi më i madh i Shqipërisë, Berisha armik i madh i demokracisë..., heu!

I KATËRTI: Po, cili shkrimtar yni pat thënë se armiku i shqiptarit është vetë shqiptari, andaj nuk është e habitshme...

I DYT: Qy-qy... po i mençur na u ke ba ti, ore! E meriton një çaj prej meje...

I KATËRTI: E meritoj, pra, hajde qite çajin!

I PARI: E çuditshme dhe jo bash e pritshme kjo, ani pse në do gazeta e akuzonin Salën për do dallavere...

I TRETI: Valla, s'di, veç e di se Sala ka qenë figurë e madhe historike e politike, e çka u ba s'po di...

I PARI: Ti s'e di, por Amerika e di...

I TRETI: Po, ku u gjet e ndodhi kjo bash tash, kur ne jemi n'pritje se çka do të vendoset në Bruksel për marrëveshjen me Serbinë?!

I DYT: Epo, çka thash ma herët: Sa herë pritet të vendoset diçka për Kosovën, në Shqipëri pa ndodhë diçka s'bën! A nuk është kështu, a?

I KATËRTI: Hajt bre se kalojnë të gjitha... Rroftë Amerika se krejt rregullohen! Po, hajde ta pimë edhe nga një çaj dhe e lëmë këtë muhabet...

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:
Gani DILI

Redaktor përgjegjës:
Isa ILAZI

Menaxher:
Driton DILI

Redaksia:
Safet Krivaça (reporter i lirë)
Nderim Neziri (redaktor)
Besiana Dili
Drenushë Haredinaj
Rilinda Krasniqi
Dionita Sadrija
Gresa Mehmeti
Ardita Dili

Dizajni:
Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:
Fahu postal 18, 10000 Prishtinë
Tel: 038 51 75 75
Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:
Tel: +383 44 143 448;
Email: marketing@kosovarja-ks.com

Para 22 viteve, pikërisht më 16 maj 1999, është hera fundit që është parë duke dalë nga burgu i Dubravës dhe prej asaj dite emri i Ukshin Hotit ndodhet në listën e personave të zhdukur...

Ky kolos i çështjes kombëtare, me mungesën e tij fizike e intelektuale, do të mbetet një prej korifenjve të rrallë të mendimit politik shqiptar.

Konceptet dhe idetë e tij politike e filozofike ishin ngushtësisht të lidhura me aspiratat shtet-ndërtuese të shqiptarëve, kudo që ndodhen ata.

Prandaj, sot, kur përkujtojmë mospraninë e tij fizike, mundohemi disi ta kompensojmë këtë, duke emërtuar një prej rrugëve të Shkupit me emrin e Ukshin Hotit.

Shkupi i Dardanisë së lashtë nuk do ta harrojë asnjëherë këtë kolos të çështjes kombëtare, sepse vetëm duke e risjellë në vëmendjen e gjeneratave të mëvonshme emrin e tij, plotësojmë edhe një amanet ndaj të gjithë atyre që sakrifikuan për mirëqenien tonë kombëtare, ku, pa dys-

Kur u pa për herë të fundit Ukshin Hoti?



Ukshin Hoti dhe Edi Shukriu

him, bën pjesë edhe arkitekti i mendimit politik shqiptar – Ukshin Hoti.

Skender Asani

DITA E FUNDIT E UKSHINIT ME NE!

Më 16 maj 1999

E diel ish atë ditë.

Dita e fundit e Ukshinit me ne.

Ata që e zbatojnë ligjin
hynë dhe e morën nga pavijoni,
Siç merret dashi me këmborë.

Ne u gëzuam, ja po funksionon ligji,
Po sytë e Ukshinit shihnin një
dasmë

që ne s'e shihnim.

Kë po e martonin që po bënin
këtë fli kaq të madhe?

O Zot, çfarë dasmë e zezë

kjo dasma e tyre!

16 maj 2021

Sali Bytyqi



Ukshin Hoti në gjykatën komuniste



Keq të shkosh në spital për shërim e nuk ka barëra. Por, edhe më keq që pasdite nuk ka as mjek, sepse ikin në klinikat e veta private...

Në QKUK më së shpeshti i dëgjon fjalët: "Mos të bëftë Zoti për spital të Prishtinës!". Dhe, nëse e tëhollojmë shumë këtë fjali, domethënia e saj nuk vlen vetëm për spitalet, por ajo kapë një fushë të tërë veprimtarish njerëzore dhe qeveritare, humane e johumane...

Pamje e shëmtuar është kur pacientët dalin në pizhame për të blerë ilaçe, apo edhe më keq, ai që pas një a dy ore ka për të hyrë në operacion, duhet të dalë për të blerë opiumin që do ta hedhë në gjumë disa orë. Dhe, kjo skenë trishtuese e QKUK-së, apo e Ministrisë së Shëndetësisë, nuk ndodhë vetëm tash, por me vite të tëra. Ndërrohen drejtorët, stafi udhëheqës, por gjendja është e njëjtë! Nuk ndryshon gjë për pacientët.

Mizoritë vazhdojnë, vazhdojnë...

Mjekët, e që emërohen për të bërë punën e vet, bëjnë politikë për të

Mos t'bëftë Zoti për spital të Prishtinës!

mbetur në kolltuk. Por, as kolltuku nuk u zgjat shumë, sepse qeveritë të ne ndërrohen edhe brenda natës!

A SHËROHET PACIENTI VETËM PSE SHKON NË SPITAL?

E, pse pacientët shkojnë në spital kur nuk ka barëra, kur nuk ka infuzion, kur nuk ka as gjëra elementare? A shërohen vetëm nëse shkojnë në spital? Pa dyshim, nuk shërohen vetëm kur e shohin spitalin dhe kur thonë se jemi në spital, sepse spitaleve u duhen barëra, u duhen infuzione, u duhen opium, u duhen trajtime dhe prani të mjekut në orarin e punës dhe shumë e shumë gjëra të tjera.

Nuk shërohen pacientët vetëm duke u dhënë bukë e patate nga kuzhinat e klinikave të QKUK-së!

E, pamjet e mjekëve, duke folur në konferenca shtypi vazhdojnë,

pacientët duke blerë ilaçe vazhdojnë, por edhe i një numri të madh mjekësh, duke braktisur repartet për të shkuar në klinikat e veta private vazhdojnë. Të gjitha vazhdojnë...

PSE ASKUSH NUK E KA GAJLE PËR PLEQ E PLAKA?

Ditë më parë, teksa prisnin pensionistët të merrnin vaksinën kundër Covid-it, ata, jo vetëm që pritën me orë të tëra në këmbë, por u desh edhe të konfrontohen me policinë, e cila mendohej të mbante distancën ndërmjet tyre.

Dhe, pse ndodhi kështu?

Sepse Qeveria, konkretisht Ministria e Shëndetësisë, nuk kanë plan se si t'i vaksinonjë të moshuarit! Nuk kanë plan siç bënë Edi Rama me vaksinimin e popullatës në Shqipëri...

S. Murturi

Si u dogjën në autobusin që u bombardua mbi urën e Lluzhanit Drita dhe Fexhrije Musa?

Me nga një kurorë përmbi, në Orllan, varret e familjes së Dediqëve, sikur i bëjnë roje Orllanit, popullata e të cilit qe futur në kolonë për t'u drejtuar në Shajkoc e Gallup, nga edhe pat njerëz të zhdukur pa gjurmë nga ky lokalitet, por edhe të vrarë nga bombardimi i autobusit, mbushur me shqiptarë, mbi urën e Lluzhanit!

SI KANË NDODHUR TË GJITHA KËTO?

"Tri javë kemi qëndruar në Orllan, nën qiellin e hapur, me droje se cili tmerr do të na kaplojë neve, që jemi vetëm shtatë kilometra vijë ajrore larg kufirit me Serbinë", fillon rrëfimin Sabrije Zeqiri (1962), nënë e gjashtë fëmijëve, që aktualisht jeton nën tendën e madhe në maje të kodrës, të ngritur nga KFOR-i. Bëjmë me dije se kjo bisedë është realizuar në vitin 2000, në oborrin e tendës së saj. Gruaja që jeton për gjashtë fëmijët e mbetur dhe që është vetë nënë e babë në kodrën e izoluar nga njerëzimi dhe të rrethuar nga të gjitha anët me male, pret të dëgjojë çfarë do qoftë për bashkëshortin e zhdukur, në prag të ndërhyrjes së forcave të NATO-s në këtë anë dhe të pajtohet me fatin apo fatkeqësinë, pavarësisht epilogut. "Unë - thotë ajo - jam e interesuar të gjej një shenjë të bashkëshortit, që t'më shërbej si informacion orientues se ai është i gjallë apo i vdekur. Në fund të fundit, ne jemi të gjithë më të vegjël se Kosova dhe e kemi borxh të vdesim për Kosovën. E kemi paraqitur

rastin kudo - në Kryqin e Kuq Ndërkombëtar, por ende nuk kemi marrë asnjë informatë të vetme për të.

Pas tri javësh kanë ardhur forca të mëdha serbe me teknikë luftarake dhe këmbësori e na kanë tubuar të gjithëve, duke krijuar kolonën, e cila e kishte rrugën të hapur vetëm në drejtim të fshatit Shajkoc.

Mbi 130 vetë kemi qëndruar dy javë na xhaminë e Shajkocit, në kushte të rënda, tmerrësisht të rënda, nën parandjenjen e rëndë se kur do të na vrisnin të gjithëve. Me ne ishin shumë fëmijë dhe i kaplonte trishtimi, paniku. Nuk kishim ushqim. Mbi të gjitha, nuk kishim as barëra që na duheshin, sepse jetën e bënim nën kushte të rënda...

Dhe, pas qëndrimit në Shajkoc, një javë para se të tërhiqeshin forcat serbe në qershor 1999, jemi kthyer në shtëpinë e djegur, së cilës i kishin mbetur vetëm themelet, pa ditur si do vjen dita e fundit e jetës sonë kolektive...

Bashkëshorti im, vetëm dy ditë para ndërhyrjes së forcave të KFOR-it në këtë rajon, ka marrë rrugën për në Batllavë, duke udhëtuar me një njeri nga kjo anë.

Atë ditë, deri në orën 18, e kanë parë njerëzit, por më pas është zhdukur në Batllavë dhe deri më sot asgjë nuk dimë për fatin e tij. Dyshimet se mund të ketë hasur në forcat paramilitare-ushtarake serbe, janë evidente, por çfarë ka ndodhur me fatin e tij, ende nuk dimë gjë. I frikësohemi më të keqes, sepse nuk është e mundshme të mos ketë asnjë informacion për të, nëse ai është akoma gjallë. KFOR-i na e ka ngritur këtë tendë këtu dhe do e kalojmë edhe dimrin që do vjen në tendë, derisa ta mbarojmë shtëpinë e re. Poshtë KFOR-i ka filluar ndërtimin e një shtëpie të re për ne. Na kanë lutur të shkojmë në Prishtinë derisa të ndërtohet shtëpia. Por, nuk kam pranuar ta braktisi oborrin tim, me dyshim se atje do e kam më vështirë jetën për fëmijë. Sidoqoftë, kam vendosur të mos e braktisi fshatin pa kuptuar për burrin, edhe pse këtu jeta është e vështirë, pasi nuk ka asnjë banor përreth nesh. E, falënderimi për jetën tonë i takon KFOR-it. Ai na sjell ushqim, veshmbathje dhe bën përkujdesje për çdo nevojë tonën", thotë Sabrije Zeqiri, nga Orlani i Podujevës.

Ç'THOTË MIHANE MUSA PËR "TIGRAT" ME SHAMI NË KOKË?

"Kemi jetuar me ethe tmerri nga lëvizjet e forcave të mëdha militare e paramilita-

re serbe që vinin me teknikë të kombinuar dhune për të prerë e për të vrarë. Më 18 prill 1999 forcat serbe kanë granatuar tërë natën mbi Orlan dhe jemi detyruar që natën e ftohët ta kalojmë nën qiell të hapur në mal", tregon Mihane Musa, 60 vjeçe, nga Orlani, nënë e dhjetë fëmijëve dhe shton: "Në të dy anët e rrugës ishin të pozicionuar "Tigrat e Arkanit", që mbanin në kokë shami të lidhur. Ata mbanin pozicionet rreth rrugës dhe misioni i tyre ishte të vrisnin, plaçkitnin... Nga Ballabani jemi detyruar të kërkojmë shpëtim, duke u futur në thellësi të Gallapit, me shpresë se atje do të ishte më qetë. Por, kur kemi arritur në Makoc, e kemi kuptuar se edhe aty ishte i njëjti koncentrim i forcave të Arkanit. Në Makoc nuk kishte mundësi qëndrimi të mëtejshëm dhe më 19 prill, kolona e të dëbuarve shqiptarë, në orën 11, vendosi të nisej për në Prishtinë, të përcjellë nga "Tigrat", të vendosur në të dy anët e rrugës. Në fshatin Makoc kishte lëvizje të mëdha të forcave serbe... Por, pasi e kaluam kazermën në Llukar, paramilitarët serbë filluan të plaçkitnin popullatën, duke ua marrë edhe metelikun e fundit, nën kërcënimin se do të vriteshin të gjithë. Kërcënimi ishte se do të vriteshin fëmijët nëse prindërit nuk paguanin për gjakun e tyre. Megjithatë, synimi ynë ishte Prishtina, por paramilitarët dhe policët nuk na lejuan të futemi nëpër lagje, duke na drejtuar për në Llap. Dhe, përpjekje pas përpjekjeje, arritëm sërisht në Shajkoc, ku ndodhej një masë e madhe njerëzish. Aty kemi qëndruar të rrethuar nga forcat serbe, ndërkohë që xhamia ishte stërmbyshur me shqiptarë, por edhe fshati ishte i mbushur me popullatë civile. Aty kanë vdekur shumë njerëz nga mundimet..."

SI E VRANË STUDENTEN VEPRIMTARE DRITA MUSËN MBI URËN E LLUZHANIT?

"Më 30 prill 1999, Drita Musa, studente e vitit të tretë të Fakultetit Teknik dhe kushërira e saj, Fexhrije Musa, kanë marrë rrugën për në Prishtinë, për të shkuar te mjeku, meqë gjendja e tyre shëndetësore përkeqësohej", tregon nëna e Dritës, Mihane Musa. Ajo tutje, lidhur me vrasjen e Dritës dhe të Fexhrijes nga avionët bombardues të



Fexhrije Musa

NATO-s, rrëfen:

"Në mëngjesin e fund-prillit vajzat janë nisur për në Prishtinë. Drita ishte veprimtare e dalluar e lëvizjes studentore në Prishtinë dhe mburremi edhe tash për punën që ka bërë ajo në organizimin e protestave studentore në kundërshtim të regjimit serb në Kosovë.

Mbi urën e Llukshit, një aeroplan bombardues i NATO-s ka hedhur bombë-kasetë për të asgjësuar urën, e që në atë moment ndodhej autobusi me udhëtarë që shkonte në drejtim të Prishtinës.

Në autobus janë vrarë shumë udhëtarë. Drita dhe Fexhrija janë asgjësuar fizikisht nga zjarri që kishte kapluar autobusin pas bombardimit dhe nga përplasia e tij në tokë nga ura. Nga ai autobus kanë shpëtuar pak njerëz që ishin udhëtarë. Kufomat e Dritës dhe të Fexhrijës kanë mundur të identifikohen vetëm në spitalin e Prishtinës, ndërsa shpjegimi i të mbijetuarve në këtë aksident ishte rrëqethës. Autobusi i firmës "Nish Ekspres" kishte sjellë forca paramilitare në Podujevë. E, në Podujevë ishte mbushur me shqiptarë, për t'i sjellë në Prishtinë, por ishte goditur nga raketa mbi urën e Llukshit.

Dhe, Gentiana e vogël, prej atëherë, nuk i përshëndet me dorë avionët e NATO-s, me hidhërimin se ia kanë vrarë motrën, Dritën, 23 vjeçe, mbi urë, edhe pse nuk meritonte të vdiste në atë mënyrë as ajo e as Fexhrija 29 vjeçe.

Safet Krivajca



Drita Musa

Zhgënjim dhe gëzim bashkë...

Ranë plantacionet me ullishte rreth aksit rrugor Kavajë-Lushnjë, rrugë nëpër të cilën kalova ditë më parë (nëpër të kisha kaluar vetëm një herë, para 31 vjetësh, më 1 shtator 1990), e që më frymëzuan ta bëj këtë shkrim...



Më 1990, skamje e varfëri si në kohën e Migjenit

Gati po bëhen 31 vjet nga 1 shtatori 1990. Po atë ditë këmba ime shkeli për të parën herë në Shqipëri, në pikën kufitare në Kapshticë (kufiri me Greqinë). Ishte kjo ëndërra ime më e madhja në jetë (veç lirisë së Kosovës) për të cilën, po ashtu, ëndërruam gjatë e gjatë, e, më në fund, erdhi edhe ajo ditë.

Aso kohe turma e madhe e njerëzve në kufi që kërkonin bukë ishte e madhe. Fëmijë të leckosur si në tregimin "Luli i vocërr", burra e gra me flokë të palarë si në vargjet "Kafshatë që s'kapërdihet asht or

vëlla mjerimi", të Migjenit, më emocionuan, më prekën në shpirt. M'u mbushën sytë lot... M'u kujtuan lisat e gjatë e fushat e gjëra me lule të Naimit, e që nuk shihja kund lisa e as fusha veç bunkerë e kodrina boshe, të thata, të zhveshura e rrugica me pluhur si në Saharë... S'mund ta përmbaja veten nga emocionet, nga lotët, aq nga kureshtja që shkela në tokën e ëndërruar, e po aq nga pamjet trishtuese që asnjëherë nuk i kisha imagjinuar se mund t'i shihja në Shqipërinë e ëndrrave të brezit tim, dhe jo vetëm të brezit tim...

BUNKERËT NË VARREZA!

Jo larg pikës kufitare kudo shihje bunkerë... Disa të vegjël, e në mesin e tyre një i madh, të drejtuar drejt Greqisë!

E gjatë e me plot rreziqe ishte rruga nga pika kufitare Kapshticë për në Korçë-Elbasan-Tiranë, sepse hasja edhe në fëmijë që gjuanin anash, madje edhe me gurë! Rrugët me gropa, plantacionet e ullishteve të shkatërruara (kishin mbetur vetëm drunjtë, meqë degët ua kishin thyer dhe dukeshin trishtueshëm).

Dyer e dritare në shitoret e Tiranës nuk kishte. Hynin fëmijët dhe të tjerët nëpër dyer e dilnin nëpër dritare...

Në autobusin e qytetit njerëzit rrinin në këmbë dhe me ombrella të hapura, sepse

shiu që binte pikonte mbi kokat e tyre... Në Durrës, në plazhin disa kilometra të gjatë, ishte vetëm hoteli "Adriatik". Bunkerët si kërpudhat shiheshin kudo nëpër plazh, me dritaret e vogla drejt detit... Aq më keq, bunker pash edhe në varreza! Dhe, çka jo tjetër? Por, nuk dua t'i kujtoj të gjitha, sepse më rrëqethet trupi... Kur u ktheva në Prishtinë, pas tri ditësh qëndrimi në Shqipëri, një kohë të gjatë nuk më hiqeshin nga mendja ato pamje, ai trishtim...

Dhe, shumë vjet më nuk shkela në tokën "e amshuar". Sepse, zhgënjimi ishte i madh dhe nuk dëshiroja t'i shihja edhe njëherë ato pamje trishtuese...



RRUGËTIMI QË BËRA DITË MË PARË...

Në këtë pranverë pandemie, mora rrugën për në Sarandë. E, teksa udhëtoja në aksin rrugor nga Kavaja për në Lushnjë, shpirtin ma kënaqën pamjet e mrekullueshme, plantacionet e ullishteve më mbushën emocione. Ullinjtë ishin rritur, ishin mbushur degë e gjethe. Asnjë dru i dëmtuar, asnjë degë e thyer...

Ato pamje të bukura m'i kujtuan pamjet në parqet me drunjtë në Londër, e që kur isha atje, para 30 vjetësh, mendoja se vend më të bukur s'ka. M'u kujtuan edhe vendet e bukura në Norvegji, Suedi, Danimarkë, Gjermani e Austri, madje edhe në Turqi, në brigjet e Detit të Zi: në qytetet Bafër e Samsun, atje ku edhe jeton një numër i madh shqiptarësh, pastaj vendet e bukura të arbëreshëve të Greqisë, konkretisht në Florinë.

Por, pamje më të bukura se plantacionet e ullishteve në kodrinat ndërmjet Kavajës e Lushnjës nuk më ka rënë të shoh. Zemra më bëhej mal nga pamjet madhështore...

NË MYZEQENË E KOSOVARËVE...

Nga Lushnja për në Fier më nuk ka plantacione masive të ullishteve, veç ndonjë kodrine aty-këtu. Fieri sikur ma zbehe pak atë kënaqësi që kisha më parë, sepse kishte mbetur paksa më pak i zhvilluar. Pse? A thua se këtu dhe në rrethinën e tij, në rajonin e Myzeqesë, jetojnë shumë kosovarë, apo?

Dhe, pa dashje më kujtohet Sulejman Tafilaj, personazh i Jakov Xoxës në "Lumi i vdekur", i cili për të ikur nga presioni që i bëhej nga pushteti i kohës, lë Kosovën dhe me familje ia mësyn Shqipërisë për të gjetur rehatinë. Por, edhe atje, regjimi i bejlerëve e përzënë për në Myzeqe, ku do bëjë jetën e re në moçalet e shumta të kësaj krahine, në luftë me mushkonjat, bashkë me shumë kosovarë të tjerë, sidomos nga rrethi i Podujevës...

Si pa dashje, më shkon në mendje: A thua,

s'e ka shumë kosovarë në këtë rajon ka mbetur Fieri më pak i zhvilluar në krahasim me qytetet përreth?

"SYRI I KALTËR" DHE KSAMILI, ME BUKURI SI NË PËRRALLA

22 kilometra pa arritur në Sarandë, në territorin e Delvinës, afër aksit rrugor Gjirokastrë-Sarandë ndodhet "Syri i kaltër", me pamjen si në përralla. Në madhësi të një bunari shumë të madh, uji i pastër, ngjyrë kaltër, del nga toka dhe krijon lumin e quajtur "Bistrica".

Por, habitem se si në Sarandë, krejt në jug të Shqipërisë, hasim në fjalën sllave "Bistrica" (ujë i pastër), thuajse nuk ka mundur të zëvendësohet me fjalë shqipe gjatë historisë! Mund ta marrë me mend se një gjë e tillë i ka shkuar për shtati mbretit Zog, i cili ka qenë i lidhur me Serbinë, me ndihmën e së cilës edhe e rrëzon qeverinë demokratike të Nolit dhe vetë bëhet mbret! Por, nuk gjej arsytim pse emrat sllavë në Shqipëri nuk janë zëvendësuar me emra shqip në kohën e regjimit të Enver Hoxhës?!

Sidoqoftë, toponime sllave në Shqipëri ka sa të duash, e sidomos në pjesën jugore të Shqipërisë. Konkretisht, afër vendbanimit Dhërmi ndodhet fshati i njohur Vuno, fshat i cili është nën mbrojtjen e UNESCO-s. Fjala "vuno" është sllave, që do të thotë "lesh". Po ashtu, afër Vlorës është edhe fshati Novosellë (fshati i ri) e të tjerë që nuk janë për t'u përmendur, meqë unë nuk jam studiues.

Tutje ia mësyj Ksamilit. Ishujt e Ksamilit m'i kujtojnë reportazhet e ndryshme të ishujve Maldive: uji i pastër, ishujt e bukur, pamjet madhështore...

Më pas kthehem në Sarandë. Dhe, më duket sikur ka elemente të relievit të Ulqinit. Ngjitem edhe në Kalanë e Lëkurësit, nga shihet e tërë Saranda e bukur dhe Korfuze grek. Një anije shumë e madhe shihet teksa lundron ndërmjet Ksamilit dhe Korfuzit, në drejtim të Greqisë...

E, në mbrëmje, më habit fakti se pak njerëz shoh në shëtitoren e bukur të Sarandës përreth detit, por edhe në lokale. Ndoshta pse është kohë pandemie...

Dhe, nga Saranda për në Vlorë, dosido, ndalem në plazhin e Borshit. Uji i pastër dhe gurët e vegjël i japin pamje të bukur plazhit, por edhe natyra përreth.

E, në Himarë, po s'u ndale, s'ke bërë gjë. Më dukej sikur jam në Plazhin e Vogël të Ulqinit. Por, këtu, uji i Detit Jon është shumë i pastër, si uji që pimë, dhe i jep madhësi të veçantë Himarës.

Ishte koincidence se po atë ditë, teksa rrezitesha në plazh, kishte takim me banorët e Himarës Edi Rama, në kuadër të



...askush nuk punonte

fushatës zgjedhore. Kah ora 15, si ushtarët e KFOR-it pas lufte në Kosovë që e rrethonin ndonjë objekt të dyshimtë, e rrethuan qendrën e Himarës njerëz me veshje të zeza e kokëqethur, truporë të Ramës dhe nuk lejonin askënd të afrohej afër restorantit ku në ato çaste arriti Edi Rama, edhe ai i veshur me të zeza! I gjatë, i madh, dallohej mbi gjithë të tjerët...

Kamerieri, i cili në ato çaste ma solli kafënë, në restorantin tjetër e jo aty ku më pas do të fliste Rama, më tha: "E pe, erdhi Rama?"

"Po, e pash. Erdhi dhe shkon! Çka ka me bë tjetër?!", ia ktheva me qeshje.

Dhe, nga Himara për në Vlorë, rruga buzë bregdetit është me kthesa të shumta.

Një kthesë në të majtë të qon poshtë në plazhin më të bukur të detit Jon, në Jale, në mrekullinë që di ta krijojë vetëm natyra...

E, pak më larg ndodhet kalaja e Ali Pashë Tepelenës. Tutje ndodhet fshati i mbrojtur nga UNESCO, Vuno, më pas plazhi i Dhërmisë, plazh shumë i frekuentuar verës nga të rinjtë, sidomos kosovarët.

E, në vazhdim të rrugëtimit, nisë përpjeta nëpër Llogara, me relief shkëmbor të zhveshur dhe pamje trishtuese kur kthen kokën të shohësh poshtë detin...

Dhe, kthesë pas kthese, lartësi pas lartësie, pas një kohë të gjatë vozitjeje, arrin në maje të Llogarasë, ku nga maja shihet në horizont një pjesë e madhe e detit Jon, por edhe Korfuze dhe ishujt të tjerë të Greqisë.

E, kur fillon të lëshohesh teposhtë, nisin pishat e larta dhe drunjtë tjerë, që të duket vetja se je duke u kthyer nga Prevala për në Brezovicë...





Hoteli "Liro" në Vlorë

KAFE MBI UJË NËN STREHËN E NJË SHKËMBI

Edhe pjesa nga Orikumi për në Vlorë e bukur. Por, s'di njeri ta përshkruaj bukurinë natyrore ku ndodhet hoteli "Liro", i ndërtuar nën një kërrsh shumë të madh e mbi ujin e detit...

Pas pak vjen Vlora. Vlora heroike e Ismail Qemalit. Kur e pyeta një kalimtar se a je nga Vlora, ma ktheu:

"Po, nga Vlora jam".

"Nga Vlora heroike, a?", i thash.

"Vlora heroike?! Piuuuu! Na ishte një herë!", më tha me një qeshje të lehtë.

Vlora, nga vendi "Uji i ftohtë" e deri në qendër të qytetit, me rrugët e bukura me palme anash, të shtynë të mendosh: Je në Shqipëri apo në Floridë të Amerikës?!

Dhe, rrugës për në Prishtinë, natyrisht, ndalem në Tiranë, të cilin qytet nuk e kam parë që nga shtatori i vitit 1999. Në atë kohë, në parkun afër hotelit "Tirana", grupe

njerëzish luanin bixhoz me letra, e shumë të tjerë i shikonin... Kisha përshtypjen se askush nuk punonte asgjë, por sillleshin vërdallë, siç thuhet në popull, "si terzia pa penj".

Por, a ishte edhe tash ashtu?

Kudo nëpër Tiranë gumëzhnin njerëzit, veturat e shumta, e që krijonin edhe kolona me kilometra...

Madje, e ke vështirë të gjesh një vend për parkim. Dhe, u gëzova kur, pas shumë bredhjeve rreth qendrës, më në fund, afër Universitetit Shtetëror, një veturë doli nga parkingu e unë shpejt e shpjet, siç thonë pejanët, e grabita dhe e parkova veturën. Nisi të shëtis sheshit të Tiranës, nga Universiteti drejt hotelit "Tirana", në afërsi të të cilit ndodhet edhe shtatorja e Skënderbeut, me pamjen si shtatorja e Prishtinës, e që dikur shtatorja e Skënderbeut në Tiranë kishte pamje tjetër...

Dhe, në çast, më befason pamja kur afrohem afër vendit të quajtur "Blloku" (shtëpia e Enver Hoxhës dhe e funksionarëve të tjerë të partisë). Më 1999 "Blloku" ishte i rrethuar me grila hekuri të lartë dhe policët ndodheshin në çdo cep të tij.



Syri i kaltër, afër Delvinës



Maldivet e Shqipërisë - Ksamili



Plazhi i bukur, Jale



Nga lartësia Llogarasë, shihet Korfu i Greqisë

E shikoja atë ambient që aso kohe ishte i vetmi me pamje të bukur në Shqipëri dhe sikur e shihja Enver Hoxhën teksa shëtiste nëpër oborrin e madh me lule të të gjitha ngjyrave...

Pse e bëja këtë?

Sepse, ne, kosovarët, brezi im, por jo vetëm imi, me pak përjashtime, e kemi dashur shumë Enverin. E kemi dashur shumë Shqipërinë. Nuk dua të hyjë në hollësi, por unë njoh shumë njerëz që janë kalbur në burgjet e Jugosllavisë vetëm pse e kanë përmendur me dashamirësi Enver Hoxhën, e kanë lartësuar Shqipërinë e Enverit. E, kush nuk qau kur vdiq Enveri?! Nuk qanë vetëm ata të llojit të Ali Shukrisë e Sinan Hasanit...

E tash?

Tash vetëm Vila e Enver Hoxhës ishte e rrethuar me grila dhe ishte shndërruar në muze. Në hyrje qëndronte policia...

Pjesa më e madhe e oborrit të Enverit tash ishte shndërruar në park, në të cilin në ulëse pushonin kryesisht të moshuarit, e në gjelbërim luanin fëmijët.

Vetëm bunkerët dhe pishinat ishin të paprekura, në shenjë kujtimi...

Por, përshypje, e që nuk e hasim te ne në

Prishtinë, më la shiriti i betonit përgjatë gjithë oborrit të ish-"Bllokut", ku pjesa më e madhe e tij ishte me libra të vjetër e të rinj, që shiteshin. Shikoj libra të ndryshëm të shkrimtarëve tanë, por edhe botërorë. Por, edhe shumë libra të vjetër e të rinj që janë shkruar për Enver Hoxhën...

Dhe, teksa e marrë në duar librin e Blendi Fevziut me titull "Enver Hoxha" (në ballinë Enveri paska i mërrolur), im nip, Joriku, nxënës i klasës së gjashtë, e që ishte me mua, më tha:

"Ky është Enver Hoxha, a?! Kudo ku kemi parë bunker më ke folur për të! Më fole për të edhe te Kalaja e Ali Pashë Tepelenës, kur në murin e kazermës së rrënuar, lexuam atë që shkruante: "Rroftë Partia Komuniste e Kinës me në krye shokun Mao Ce Dun!". I keq paska qenë!"


Një buzëqeshje e lehtë më erdhi vetvetiu....

"Eh, nip, të kishe jetuar në kohën e rinisë sime, me ëndrrat e brezit tim, a thua, a do kishe thënë i keq paska qenë Enver Hoxha?!", e solla në mendje...

Isa ILAZI



Ullishtet në aksin Kavajë-Lushnje



Shtëpia e Enver Hoxhës, tash muze

Shqiptarët e Kosovës nuk e harrojnë të kaluarën. Ata nuk e harrojnë dot Enver Hoxhën, sepse për ne, kosovarët, Enver Hoxha kishte kuptim ekzistencial, meqë deri në fillim të viteve 60, nga zullumi i Serbisë u përzhunë gjysma e popullit shqiptar të Kosovës për në Turqi. Enveri ishte burrështetasi që me varfërinë e tij shtetërore, e që ne nuk e njihnim, prisnim të na e sillte shpëtimin dhe bashkimin kombëtar.

Edhe Sali Berishës ja mbajmë mend dërgimin e naftës Milosheviqit, në kohën kur bota i bënte embargo Serbisë! Por, edhe ndërtimin e “Rrugës së kombit”, e që ishte iniciativë e presidentit Rugova, që të pimë kafe brenda 3 orësh në Tiranë...

Por, edhe Edi Ramës ja mbajmë mend të këqijat dhe dyshimet, sidomos me Mini-Shëngenin Ballkanik dhe pagesën 5 euro për kalim nëpër “Rrugën e kombit”, e që ka synim t’i shfrytëzojë dhe t’i vjelë kosovarët!



Pika kufitare në Rrugën e Kombit

Kush e këndonte qëmoti këngën “Ra Sala prej fiku!”?

Në vitet 70 dasmat bëheshin nën përcjelljen e grupeve muzikore amatore, por të cilat e kishin krijuar një imazh falë zërit që u kishte dal në masë.

Dhe, për të mos i përfshirë këtu disa grupe që këndonin me sharki e çifteli, po e marr shembull grupin “Ruhanët”, me seli në Gadime të Lipjanit. Kryesuesi i grupit ishte Ruhani, një defxhi i njohur, që nuk i gjendej shoqi kund dhe që bënte lojë me def me të gjithë gishtërinjtë e të të dy duarve.

E kishte ushtruar për dhjetëra vite zanatin dhe e kishte defin me “xhempare”, të cilët dridhnin dhe bënin shumë zhurmë. “Ruhanët” ishin njerëz shumë të respektuar në fshat e më gjerë, për të cilët, ai që i donte në dasmë, duhej të zinte rendin një vit më parë, njëjtë si dikur që bënin gjakovarët me Ismet Pejën e tash me Xenin...

Por, Edi Rama, fitues i tre mandateve të zgjedhjeve në Shqipëri, u bë sebeb e ma kujtoi Ruhanin e Gadimes, defxhiun e madh të asaj kohe.

E, ku lidhet tash Edi Rama me Ruhanin? Ndryshimi qëndron në atë se Ruhani këndonte në dasma, kurse Edi Rama, gjatë fushatave zgjedhore, këndonte teksa udhëtonte me autobus nga një vend në tjetrin...

Edi Rama në autobus e shprehte ndjenjën e gëzimit jo për fitoren e vet, por për dëshirën që kishte që të binte nga pushteti Sali Berisha. Ishte kënga popullore “Ra Faja prej fiku”, që u parodizua me përshtatjen politike “Ra Sala prej fiku”, si një kënaqësi që Sali Berisha do i humbë zgjedhjet në Shqipëri.

Dhe, me skemën në autobus, Edi Rama ishte bërë defxhi si dikur Ruhani, pak zeshkan e pak gazmor. Pamja e tij me humor në autobus edhe tash ma kujton Ruhanin, defxhiun e Gadimes së Lipjanit, e që e njihte pothuajse e tërë Kosova. Mirëpo, për dallim prej Edit, Ruhani nuk kishte kundërshtarë fare. Kjo tregon se ai ishte më i pranueshëm se Edi Rama, e që sivjet i fitoi zgjedhjet për së treti herë në Shqipëri. Por, populli i Kosovës e di se Partia Socialiste e Shqipërisë është pasuese e asaj të Enver Hoxhës, ndërsa Sali Berisha e nxori Shqipërinë në kohën më të vështirë nga diktatura komuniste dhe krijoi një mit të ri demokratik në Shqipëri, e sidomos me ndërtimin e “Rrugës së kombit”, e që bëri prishtinasit të pi kafe në det, në Shëngjin, vetëm me një vozitje normale 3 orë... Por, rasti që Departamenti i Shtetit të SHBA-ve e shpalli person “non grata” Sali Berishën dhe familjen e tij, kryesisht për korrupsion, është çështje tjetër...

PËR FUND

Mirë është që po ndërrohen brezat dhe vijnë gjenerata të reja politike, të cilët, ndoshta, do të jenë pa inate dhe pa ndërskamca.

Por, duke mos harruar asnjëherë kontributin e atyre që nxorën Shqipërinë dhe shqiptarët nga diktatura komuniste e Enver Hoxhës, i cili ia kishte pirë gjakun popullit si me pambuk...

Sokol Murturi

remos®



Aachener Straße 21 | Köln
Ulmenstraße 30 | Frankfurt
Westerwaldpark 4 | WW
Bahnhofplatz 5 | Koblenz
remos-restaurants.de




[remos_restaurants](https://www.instagram.com/remos_restaurants)

100 femra u dhunuan më 22 dhe 23 prill 1999 vetëm në rajonin e Prishtinës!

Numri i femrave të dhunuara gjatë luftës në Kosovë është i madh. Por, të pakta janë ato femra që deklarohen publikisht. Sepse, pasojat e dhunimit janë të mëdha, sidomos për mentalitetin kosovar.

Në vitin e parë të pasluftës, sindromi i urrejtjes së frytit të porsalindur, e që vjen nga dhunimi, ka filluar t'i ndjejë pasojat edhe në Kosovë. Një nënë e re e ka mbytur foshnjën e vet posa e ka sjellë nga spitali në shtëpi. Dhe, nga organet e hetuesisë ka pasuar marrja në pyetje e nënës... Deklaratat e saj rreth veprës kriminale quan te ndjenja se foshnja e porsalindur ishte produkt i një akti seksual të dhunimit, që kishte ndodhur më 1999, gjatë spastrimit etnik të shqiptarëve.

Megjithatë, veprimi i tillë është vepër penale, vrasje me paramendim dhe për këtë prindi përgjigjet penalisht para drejtësisë.

100 MIJË FEMRA TË BOSNJËS KANË LINDUR FËMIJË NGA DHUNIMI

Diçka e tillë ka ndodhur edhe me gratë boshnjake, të dhunuara në luftën katërvjeçare me serbët, të cilët sistematikisht i dhunuan femrat myslimane në Bosnjë.

Gratë myslimane nga këto dhunime, duke mos pasur ku të abortojnë, kanë lindur në spitalet e Kroacisë dhe, sipas statistikave zyrtare, 100 mijë gra myslimane kanë lindur fëmijë nga procesi i dhunimeve serbe. Megjithatë, shifra e dhunimeve është edhe më e madhe, duke pasur parasysh se ka lindur çdo e treta apo e katërta femër myslimane, e kjo qon te konstatimi se në Bosnjë janë dhunuar, të paktën, 300 mijë vajza e gra!

Në shumë raste, sipas shënimeve dhe raportimeve që kanë ndodhur, shumë nëna myslimane i kanë mbytur foshnjat e tyre, menjëherë pas ardhjes së tyre në jetë. Ndërsa, ato nëna që nuk kanë pasur fuqi ta ekzekutojnë frytin e vet, foshnjat i kanë lënë në spitale, duke i braktisur apo lënë në jetimore dhe në institucionet e tjera humanitare.

Nënat e anketuara atëbotë, nga një gazetë

gjermane, shumica janë deklaruar se nëse është për ta thënë të vërtetën, 90 për qind e tyre janë për të mos i lënë të jetojnë produktet e dhunimit serb.

Anketat me nënat e reja, të dhunuara në luftën e Bosnjës, kanë treguar se historia e përjetuar gjysmë shekulli më parë, pra në Luftën e Dytë Botërore, nuk është harruar, ndërsa nënat e reja ruanin shkallë të lartë urrejtjeje ndaj serbëve që dhunimet i kanë si pjesë të mizorisë kriminale, për çka edhe në kohën kur lindën ato (shumica në Zagreb), tregon se do t'i privonin nga jeta foshnjat e sapolindura, që vinin në jetë nga aktet kriminale të dhunimeve.

Dhe, duke parë dëshirën e nënave të porsalindura që t'i mbytnin foshnjat e dhunimeve, shteti solli shpejt ligjin e veçantë, i cili, duke pasur parasysh të dhënat e dhunimit gjatë viteve 1991-1995, ndaloi rreptësisht aktet kriminale mbi foshnjat.

CILA FEMËR KA DËSHIRË TË DHUNOHET NGA ARMIKU?

Njerëzit me logjikë të shëndoshë mendore e kanë fare të qartë se asnjë femër nuk dëshiron të dhunohet, aq më pak nga armiku.

Kërkesa e këtij trajtimi tematik, si dukuri e

përjetuar në Kosovë, ka synim të vërtetën e hidhur të mizorisë së shumëfishtë serbe mbi shqiptarët, diçka që nuk është ndihmuar nga entet tona shëndetësore dhe gjinekologjike.

Dy arsye janë thelbësore, e që janë pengesë për publikimin e të dhënave mbi dhunimet:

Një, zyrtarët hezitojnë të flasin me argumente që i dinë dhe janë të ditura bukur shumë, meqë dihet numri i femrave të dhunuara në Kosovë;

Dy, hezitimi i të dhunuarave për arsye botëkuptimi konservativ.

Secila e dhunuar, në një shoqëri patriarkale si e jona, shihet me sy jo të mirë nga rrethi, pa marrë parasysh se dhunimi bëhet nën presion, sulm dhe jashtë çdo dëshire.

Njohësit e rrethanave nga këto dukuri konsiderojnë se tek pas disa vjetësh, të dhunuarat do të mund ta qelin gojën për të dhënë rezultatet e para të tragjedisë personale, por që bëjnë një kolektivitet. Vetë fakti se një grua, e cila e ka mbytur foshnjën e vet pas lindjes dhe që dihet me emër e mbiemër, e që u mor në pyetje dhe mbajtje për disa muaj, dëshmon se të tilla raste ka mjaft.

Grumbullimi i fakteve ka rëndësi të veçantë, përtej të gjitha këtyre fakteve që u sollën në këtë shkrim. Grumbullimi faktik i të dhënave mund të përdoret në Hagë, kundër Serbisë, e cila, lëre që zhvilloi luftë të ndytë, por vrau edhe foshnja, madje...

100 FEMRA U DHUNUAN MË 22 DHE 23 PRILL 1999 VETËM NË RAJONIN E PRISHTINËS!

Botëkuptimet konservatore se gratë do t'i humbin burrat, ndërsa vajzat perspe-

ktivën martesore, kanë qar te mosparaqitja e krimeve të kësaj natyre. Ajo që dihet është se në vitin 2001, kur edhe është bërë ky shkrim, një numër grash të dhunuara trajtoheshin për mjekim në Itali.

Ato trajtoheshin, por nuk flisnin si ka ndodhur ngjarja! Ka fakte se rreth 100 femra, në një fshat në afërsi të Prishtinës, janë dhunuar nga serbët më 22 e 23 prill 1999.

Të gjitha këto janë parë të jenë zbarkuar nga një automjet i tipit TAM, 18 kilometra në jug të Prishtinës, në magjistralen Prishtinë-Ferizaj.

Femrat që janë zbarkuar aty, kanë dëshmuar po atë ditë, para përfaqësuesve të fshatarëve që u kanë ofruar strehim, se serbët i kanë dhunuar dhe keqtrajtuar psiko-fizikisht.

E vërteta qëndron se një rimorkio e mbushur me femra, u sollën po në të njëjtin vend dhe u lanë të lira të shkojnë kah të duan...

Institucionalisht, një zyrtar i spitalit gjinekologjik në Prishtinë, atëbotë i tha revistës sonë, "Kosovarja", se do të del publikisht me një kumtesë rreth këtyre problemeve. Ai tha se kishte edhe dezinformata dhe ishte tepër e nevojshme të sqarohen gjërat, në mënyrë që të flakeshin të pavërtetat...

Megjithatë, ndjeshmëria tematike e bëri të veten dhe askush kurrë nuk doli zyrtarisht ta thotë të vërtetën, edhe pse Tribunali i Hagës garantonte ndjekje penale për ata që ishin identifikuar si dhunues nga pala e dëmtuar.

Ç'THONË TË ANKETUARAT PËR DHUNIMET?

Merita, 26 vjeçe, studente nga Prishtina: - Mediet duhet t'i kushtojnë hapësirë

më të madhe temës së dhunimeve. Ajo shpreh bindjen se tashmë dihet se ka shumë të dhunuara në Kosovë dhe burrat duhet të tregohen tolerantë ndaj femrave të dhunuara.

Do jetë shumë e dobishme që femrat e dhunuara të flasin dhe ta inkurajojnë njëra-tjetrën se duhet të flitet për këtë temë dhe se askush tjetër nuk mund ta përçojë zërin e dhimbjes më mirë se femrat e dhunuara.

Ajo sjell kujtimet nga kampi i Stankovecit në Maqedoni, ku edhe ka biseduar me disa femra të dhunuara...

"Unë kam qenë banore kampi në Maqedoni. Gjatë tre muajve, sa kam qëndruar atje, kam pasur rastin të dëgjoj shumë rrëfime të tmerrshme nga të dhunuarat që i mbanin në vete përjetimet e tmerrshme...

Përveç dhunimit, kam pasur rastin të dëgjoj edhe për disa vrasje të femrave që kanë ndodhur pas dhunimit të tyre.

Pse kanë ndodhur ato?

Kur dhunuesi ka qenë fqinji i saj, ai e ka kryer vrasjen, në mënyrë që ta shmangë mundësinë e denoncimit.

E, kjo është dhembje që ta kallë shpirtin, prandaj gazetat, intelektualët dhe historianët, duhet ta shpërndajnë gjithkrah faktografinë e dhunimeve në Kosovë...

Populli duhet të ketë fakte dhe ta ruajë e kujtojë historinë e tmerreve. Rinia dhe populli duhet t'i kujtojnë projektet serbe për zhdukjen e shqiptarëve, sepse, vetëm duke i kujtuar këto, ne e ruajmë identitetin tonë kombëtar", thotë ajo.

NADIRJA, 31 VJEÇE, INFERMIERE NË PRISHTINË:

"Pse femra e dhunuar t'i kërkojë falje bashkëshortit?! Asnjëra nuk e ka bërë me dëshirën e saj. Andaj, si femër, jam në lëkurën e motrave që kanë përjetuar kësopasojë, më duket ligësi morale t'i kërkojë falje gruaja burrit për shkak se është dhunuar me dhunë nga serbët. Sepse, asnjë femër nuk e dëshiron dhunimin... Kam dëgjuar se ka pasur edhe raste që femra, në përpjekje që të mos dhunohej, edhe është kacafytur me paramilitarin serb, duke e lutur ta vriste para se ta dhunonte!

Dhe, më e keqja ishte kur dhunimi është kryer edhe në prani të burrit. E, pse burri, atëherë, nuk ka rezistuar apo nuk është flijuar për gruan?!", përfundon ajo.

Sidoqoftë, dhunime të femrave gjatë luftës në Kosovë ka pasur shumë dhe duhet të bëhen publike, në mënyrë që kryesit e veprimeve të marrin dënimin e merituar...

S. Krivaça





Cili ishte amaneti i Bekim Fehmiut për djalin, Uliksin?



Bekim Fehmiu e kishte këshilluar djalin e tij të mësonte ndonjë zeje, ku do të punonte për të fituar para nëse donte të ishte aktor. Dhe, ai ishte bërë bukëpjekës.

Djali i aktorit të ndjerë, Bekim Fehmiu, Uliksi, tregon për një këshillë që ia kishte lënë amanet babai i tij.

Uliksi tregon se babai i tij e kishte këshilluar shpeshherë duke i thënë: "Duhet të gjesh një zeje, sepse me profesionin e aktrimit që e ke përzgjedhur, nuk do të kesh një punë të sigurt dhe gjithmonë varesh prej dikujt tjetër".

Dhe, kështu kishte vepruar i biri i tij. Ai ka thënë se tashmë ka mësuar zanatin e bukëpjekësit dhe se ka një furrë buke në Amerikë ku edhe jeton.



PEPTIDE COMPLEX

FACE CREAM

HIDRATUES - USHQYES - VITALIZUES DITOR

Krem 24H Peptide Complex shënjestron shenjat e dukshme moshës dhe punon për të riparuar dhe hidratuar lëkurën ditën dhe natën. Përqëndrimi i lartë i përbërësve aktivë ushqejnë lëkurën dhe reduktojnë dukjen e vijave të holla dhe rrudhave, duke rivendosur qëndrueshmërinë dhe elasticitetin e saj në të njëjtën kohë.

BENEFITET

- Stimulon Sintezën e Elastinës
- Siguron vitalitetin e dukshëm ditor të lëkurës
- Hidraton dhe zvogëlon rrudhat për një lëkurë më të butë
- Rrit elasticitetin dhe qëndrueshmërinë e lëkurës
- Lëmon rrudhat e thella dhe vijat e holla
- Promovon lëkurë dukshëm më të re
- Rinovon dhe mbron lëkurën në nivel qelizor
- Riparon aktivisht lëkurën me Bio Mimetic Peptides
- Përmirëson funksionin e barrierës së lëkurës me PhytoCellTec

INGREGIENTË

- 3 Bio-Mimetic Peptides: Argireline[®], Matrixyl 3000[®] dhe Royal Epigen P5
- 3 Types of Swiss Plant Stem Cells: Alpine Rose, Nunatak[®] dhe Grape Stem Cells

VLERËSIME

Dua t'ju falenderoj sepse asnjë produkt nuk më ka ndihmuar si produktet tuaja. Ska asnjë një javë që jam duke i përdorur dhe ma kanë pastruar dhe rregulluar fytyrën.

Unë për vete jam ndarë shumë e kënaqur me produktet, nuk mundem të rri pa to. Unë e kam lëkurën e thatë shumë dhe ma kanë bërë lëkurën shumë të butë, kurrë skam përdorur kremra më të mirë se këto.



Si u bëra *President* i Kosovës?

*Nejse, t'ua tregoj
ëndrrën dhe më
pas më thoni a kam
vepruar mirë a jo...*

Ishte arritur marrëveshja Prishtinë-Beograd e duhej të thoshim nga diçka, ne, secili prej politikanëve. Por, ec e fol në Beograd!

Dalin liderët e Serbisë dhe flasin se si është arritur marrëveshja dhe, pos të tjerash, thonë se ishte kusht dhe nuk kishin zgjidhje tjetër.

Më vjen rendi edhe mua të them ndonjë fjalë, si president i Kosovës dhe, pak si ata e pak si unë, ia kërcas politikës...

Pastaj, vjen koha për pyetje. Më pyet një gazetar serb:

"Ju, shqiptarët, a jeni spiunë të Amerikës?"

Ma dha durimin Zoti dhe ia ktheva:

"A ka qenë Milosheviqi spiun i Amerikës?"

Dhe, këtë ju duhet ta dini më së miri, në bazë të praktikës që ka ndodhur në Serbi. Ose ishte dashur të vinte një lider budalla si ai...

Ai u ka futur në baltë e ju nuk e keni ditur një gjë të tillë derisa keni sharruar mirë e mirë, pastaj e keni dëbuar nga pallati presidencial për ta nisur për në Hagë.

Dhe, të kthehemi në kohë: Së pari, nisi t'i largojë punëtorët shqiptarë nga institucionet e Kosovës për politikë.

U tha juve, serbëve, se me largimin e shqiptarëve nga puna do ua rrisë rrogat në 2000 marka gjermane në muaj...

Dhe, ju i besuat!

Pastaj, tërë bota e qytetëruar i tha mos e prekë Kosovën, kurse ai vriste çdo

ditë shqiptarë...

Tutje, në mesin e asaj arrogance dhe okupimi klasik erdhi Rambuje, në të cilën Milosheviqin e luti bota ta nënshkruante marrëveshjen e tërheqjes së forcave kriminale nga Kosova. Ai e refuzoi një gjë të tillë dhe kështu e humbi Kosovën përgjithmonë.

Andaj, ua them një të vërtetë të madhe: Milosheviqi e bëri shtet Kosovën...

Tash, shtrohet pyetja: A ka qenë ai spiun i Amerikës? Edhe nëse nuk ka qenë ka punuar për ta, ndoshta edhe pa vetëdije".

Të gjithë mbetën gojëhapur dhe zë nuk u dilte nga goja. Ata heshtnin e unë, them me vete, ua lëshova...

Sokol Murturi

Model: Egzon Maliqaj

BOOM

Egzon Maliqaj

*boksieri shqiptar
që nuk di për humbje*

**Cilat janë trupshkurtat
tona që e kallin skenën?**

**Adelina Ismaili
dhe Leonora Jakupi,
veç 9 muaj ndërmjet**

**Sa here është martuar
e ndarë Big Mama?**

**Bebe Rexha me gjoksin
si Mic Sokoli**

**Cila është magjia
e Gjon Muharremjat
në skenë?**

Cilat janë trupshkurtat tona që e kallin skenën?

AURELA GAÇE E ELEKTRIZON MASËN KUR DEL NË SKENË

Për shumë personazhe të botës së ekranit, të qenit në qendër të vëmendjes krijon jo pak shqetësim, meqë, siç thonë ata, i privon nga jeta normale që dëshiron të bëjnë.

Këtë gjë e ka konstatuar dhe provuar në kurriz këngëtarja Aurela Gaçe, e cila, ndryshe nga pjesa dërrmuese e kolegëve të saj të njohur, bën një jetë si një njeri i zakonshëm.

Sidoqoftë, në skenën muzikore ka qenë dhe mbetet e përkushtuar, duke ofruar këngë gjithmonë hite dhe duke e elektrizuar masën kur është në skenë...



PONI, KËNGËTARJA 24 KARAT

Poni është këngëtare dhe autore e shumë këngëve të njohura. Ajo bëri ndryshime të mëdha në muzikën popullore dhe stilin e veçantë të saj.

Poni njihet, kryesisht, për këngët e bukura labe dhe, pa dyshim, mund ta quajmë këngëtare 24 karatësh. Sepse, me një numër të madh adhuruesish nga gjithë trevat shqiptare, gjithmonë paraqitet me këngë të reja, por gjithmonë me vlerë.

Poni gjatë viteve ka marrë pjesë rregullisht nëpër festivale të ndryshme, si në ato të muzikës popullore, por edhe moderne dhe gjithnjë ka triumfuar...

ARTIOLA TOSKA, KËNGËTARJA QË SKENËS I JEP FLAKË!

Artiola Toska është këngëtare dhe autore këngësh shumë e njohur. Është një ndër këngëtares më të suksesshme të muzikës popullore shqiptare.

E nisi karrierën në moshë të re dhe sot është ndër emrat më të njohur të muzikës popullore në trevat shqiptare, e nderuar edhe me titullin "Mjeshtër i Madh", nga presidenti i Republikës së Shqipërisë.

Gjatë karrierës së saj ka nxjerrë 6 albume dhe i ka pasur 6 koncerte të saj.

Ka qenë pjesëmarrëse në koncerte kudo në trevat shqiptare dhe në diasporë, konkretisht në SHBA, Australi, Itali, Francë e më gjerë dhe kudo është pritur me duartrokitje të mëdha.



KIDA, E ADHURUARA E TË RINJVE


Orhidea Latifi, e lindur më 1997, në Prishtinë, është këngëtarja jonë e njohur me emrin Kida. Jeton në Prishtinë me prindërit e saj, ku, gjithashtu, kalon shumicën e kohës duke punuar.

Kida, edhe pse e re me moshë, ka publikuar shumë këngë e videoklipe. U bë fillimisht e njohur për publikun me performancën e saj në skenën e koncertit DMX dhe videoklipin e këngës "Murder", në vitin 2014.

Po atë vit publikon edhe videoklipin "Rikthejmë na", në bashkëpunim me Mc Kreshën. Me këtë këngë Kida u paraqit në këto festivale: "Zhurma Show 2014", "Kosova Fest 2014", "SVFM 2014" etj.

Pra, edhe pse e re, Kida synim i ka festivalet, sepse, sipas saj, në to edhe ka vlera artistike...

Adelina Ismaili dhe Leonora Jakupi, veç 9 muaj ndërmjet



Dy këngëtares tona shumë të njohura, Adelina Ismaili dhe Leonora Jakupi, janë dy yje të estradës kosovare. Adelina Ismaili është njëra nga këngëtares shqiptare, e cila ka thyer tabu në vitet 90, duke u shfaqur me veshje transparente, kohë në të cilën askush në Kosovë nuk ka marrë guximin të bëjë një gjë të tillë.

Por, edhe këngëtarja Leonora Jakupi, është ajo e cila ka lansuar këngë në kohën e luftës gjatë vitit 1999. Është e njohur kënga “A vritet pafajësia”, këngë kjo kushtuar Drenicës, pas vdekjes së komandantit legjendar Adem Jashari, si dhe vrasjes nga forcat serbe të gjithë familjen e tij. Megjithatë, vlen të theksohet se të dyja janë të një moshe...

Adelina Ismaili është e lindur më 1979 (më 14 nëntor), ndërsa Leonora Jakupi po të njëjtin vit (më 3 mars).

Sa herë është martuar e ndarë Big Mama?

**MË KANË MARTUAR
E MË KANË NDARË
SA HERË KANË DASHUR...**

Shumë herë për këngëtarën e njohur, Besiana Kasami (Big Mamën) është folur e shkruar se është në lidhje, se është martuar, se është ndarë... Madje, edhe se është shtatzënë...

Por, Big Mama as që është mërzhitur për thashethemet e shumta që i janë bërë. Madje, shpesh-herë ka thënë se e kanë martuar dhe e kanë ndarë sa herë kanë dashur...

“Njerëzve u intereson gjithçka, unë nuk fsheh asgjë. Nuk jam shtatzënë. Unë do bëhem hallë. Më kanë fejuar, e martuar, por kurrë nuk e kanë gjetur me kë! E kam edhe unë një të kaluar, por kurrë s’do e merrni vesh”, ka thënë tha Big Mama.

Sidoqoftë, ka kohë që këngëtarja nuk ka sjellë projekte muzikore dhe ka një arsye për këtë. Ajo tregoi se muzikën s’do e lërë asnjëherë pas dore, por nuk ka pasur të ardhura për shkak të pandemisë.

“Muzikën nuk e lë asnjëherë anash. Ndodhi ky kaos dhe na i ndaloi të gjitha. Tani vetëm të dal këtu të shes mend, e të rrej duke thënë se do bëj këtë e atë, kur nuk i kam dy dinarë në xhep! Muzika e videoklipi duan pare, por ku t’i marrim paret?! S’kemi pas as koncerte dhe as dasma. Vetëm një këngë e kam përfunduar për sezonin e kaluar veror”, thotë ajo.



Bebe Rexha me gjoksin si Mic Sokoli

*Bebe Rexha
që moti e ka
dëshmuar
veten me
kualite-
tin e saj
në muzikë,
por edhe
me dukjen
e bukur të
saj...*

Se Bebe Rexha e ka pushtuar skenën botërore me hitet e saj, këtë më së miri e dinë adhuruesit e shumtë të saj. Por, edhe pamja e bukur e saj të lë ta komentosh në forma të ndryshme dhe ta krahasosh me gjoksin e Mic Sokolit...

Pa dyshim, Bebe Rexha, e lindur e rritur jashtë Kosovës, ndoshta edhe nuk e di se kush ka qenë Mic Sokoli, por e rëndësishme është se ta krahasosh me Mic Sokolin, në cilindo aspekt, është mburrje për të...



Cila është magjia e Gjon Muharremjat në skenë?

Pas Anxhela Peristerit, që e përfaqësoi Shqipërinë në "Eurovision", ishte edhe një tjetër shqiptar, që e përloiti publikun dhe elektrizoi skenën me zërin e tij brilant, tashmë një aset për zviceranët, e që zuri vendin e tretë në "Eurovision".

Fjala është për 23-vjeçarin, Gjon Muharremaj, i cili përfaqësoi Zvicrën me këngën "Tout l'univers".

Por, ku qëndron magjia e Gjon Muharremajt, i njohur si Gjon's Tears në skenën e sivjetme të "Eurovisionit"? Magjia është pikërisht zëri i tij. Gjon's Tears është një tjetër talent shqiptar, qëllimi i të cilit është që zëri i tij të dëgjohet jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë saj.

I lindur në Zvicër, Gjon Muharremaj është më origjinë shqiptare, babai nga Kosova ndërsa nëna nga Tirana. Pavarësisht se ka lindur në Zvicër, Gjoni flet shqip pastër.

"Tani e kam një koncept dhe e di ku do të shkoj dhe se çfarë muzike dua të bëj. Muzika që unë krijoj, dëshiroj të pëlqehet si në Zvicër, ashtu edhe në Francë, Shqipëri dhe Kosovë. Më e rëndësishme është që muzika ime të prekë njerëzit, pasi ky është qëllimi im në muzikë", thotë ai.

Gjon Muharremaj për herë të parë e ka mahnitur publikun shqiptar në vitin 2011, gjatë pjesëmarrjes në "Albania's Got Talent".

Në mars 2021 Gjoni publikoi videoklipin "Tout L'Univers", me të cilën përfaqësoi Zvicrën në "Eurovision 2021", në Rotterdam të Holandës.

Sidoqoftë, vlen të përmendet se Gjon Muharremaj është përzgjedhur për të dytin vit radhazi që të përfaqësojë Zvicrën, pas këngës së një viti më parë në gjuhën frënge "Repondezmoi".



Egzon Maliqaj, boksieri shqiptar që nuk di për humbje

Egzon Maliqaj është Kampion i shumëfishtë në boks. Ai është zemër luani shqiptar, e që ka fituar përballje të forta dhe ia ka dalë të triumfojë bindshëm në pjesën më të madhe të dyluftimeve në ringje dhe gara internacionale. Është sportist i kalitur dhe inxhinier i makinerisë në Zvicër. Për të dhe jetën e tij, flasim ekskluzivisht në "Boom"...

Egzon Maliqaj, karriera jote është e gjatë dhe e suksesshme. A ndihesh krenar me çka ke arritur?

- Po, ndihem krenar me çka kam arritur deri më tani dhe ky është rezultat i investimit për ta pasur këtë sukses. Është e kuptueshme që si sportist kam dëshirë të ecë edhe më shumë e të preki majat e sukseseve botërore. Dhe, jam i bindur se mund të arrij ende, meqë karriera ime nuk ka përfunduar.

Cili është triumfi yt më i madh deri më tani?

- Kam shumë triumfe në boks in amator, janë titujt e shumëfishtë si Kampion i Zvicrës, por edhe medalja e Bronztë në Kampionatin Botëror. Si boksier profesionist, jam ende i pamundur as pas dhjetë meçeve. Madje, kam fituar edhe në meçet kundër kampioneve, siç është ai i Greqisë ose kundër boksierëve të pamposhtur nga Kolumbia dhe Bullgaria.

Si ndihesh pas çdo fitoreje?

- Ndhem i lumtur dhe krenar, por edhe me shumë emocione të mira. Çdo fitore është një vërtetim i gjithë investimit që bëj në rrugën e gjatë të përgatitjes fizike e psikologjike.

Kush është personi i parë që të uron pas çdo triumfi?

- Pas trajnerit, personi i parë që më uron është gjithmonë babai im, sepse ai vjen përherë në meçet e mi dhe, pas përfundimit të përballjes, ngjitet në ring, më uth në faqe dhe më uron. E, kur zbres nga ringu, janë familjarët: nëna, vëllai, bashkëshortja dhe shoqëria, por edhe fansat për të cilët gjithmonë gjej kohë t'i falënderoj e të fotografohem me ta...

Ç'bën pas një meçi të fituar?

- Pranoj falënderime nga shikuesit, pastaj bashkë me ekipin tim festojmë me ndonjë pije në sallë. Të nesërmen kam qejf ta kaloj kohën



me familjen e ngushtë, të hamë drekë a darkë tradicionale kosovare.

Po, nëse humbë, si ndihesh?

- Fatmirësisht, në boks profesionist ende nuk e kam humbur asnjë meç, kështu që nuk e njoh këtë ndjenjë. Në boks amator humbja e fundit ishte në vitin 2017, në turneun "EUBC International", ku jam mposhtur nga Kampioni i Francës. Jam ndjerë keq dhe i dëshpëruar me veten, sepse i dija kualitetet e mija dhe isha i sigurt se mund ta mundja atë boksier, por në ring në ato momente nuk isha në top-formë, kështu që e humba meçin me poenë.

Megjithatë, ne, sportistët, mësojmë shumë nga humbja...

Kundërshtari më i fuqishëm dhe më sfidues që ke pasur në ring?

- Në boks amator ka qenë kundërshtari nga Kazakistani, që e kisha në gjysmëfinalen e Kampionatit Botëror në Tajlandë.

Në boks profesionist, meçi më intensiv ka qenë ai në kundërshtarin nga Greqia, që e kam fituar me poenë. Edhe kundërshtari nga Kolumbia ka qenë i pamposhtur deri në atë moment. I ka pasur grushtet të fortë, andaj është dashur të kem kujdes të veçantë.

Por, edhe në këtë përballje dola fitues.

Po, ai që e ke mundur më së lehti?

- Kundërshtarin nga Gjeorgjia e kam mundur më së lehti. Madje, në raundin e parë e kam rrëzuar në tokë. Në fillim të raundit të dytë referi e hoqi nga ringu.

Pra, nuk më janë dashur as katër minuta për fitore...

A ke ndonjë ritual, diçka të veçantë që bën para se të dalësh në ring, në meç?

- Kaloj kohë me familjen, dalë të ecë me djalin tim në natyrë dhe marrë energji. Derisa jam në gardërobë, pra pak minuta para meçit, i lutem Allahut të

ma ruaj familjen, mua dhe kundërshtarin nga lëndimet e mëdha.

A ka ndodhur, ndonjëherë, që je lodhur nga boks?

- Ka pasur momente kur në përgatitjet që janë shumë të gjata e të mundimshme, nga 8-12 javë, jam lodhur shumë, sa nuk kam pasur forcë të qëndrojmë në këmbë. Pastaj, pyes veten përse bëj gjithë këtë sakrificë e investim... Por, kur jam në ring, i harroj të gjitha dhe e di që ia vlen, sepse e dua boksingun me shpirt, me zemër.

Cili është boksieri me të cilin do doje të përballlesh?

- Ëndrra ime është të boksoj kundër më të mirit për momentin, Canelo Alvarez, sepse ai është më i miri i të gjitha kategorive.

Suksesi që të bënë krenar?

- Çdo meç dhe çdo fitore më bënë krenar. Mbi të gjitha, krenar më bënë familja ime, sepse jam me fat që kam një familje shumë të mirë e që më përkrahin në çdo hap të jetës sime. Po ashtu, jam krenar edhe për bashkëshorten time, që më përkrahu që nga dita e parë e lidhjes dhe është një nënë

e mrekullueshme për dy djemtë tanë. Një falënderim të madh kam për dy motrat dhe vëllanë tim që më mbështesin maksimalisht dhe gjithë miqtë e dashamirët.

Përndryshe, ju jeni një i ri i suksesshëm. Si po të ecë puna?

- Puna më ecë mirë. Si në anën profesionale, ashtu edhe në atë sportive, në përgjithësi, ka zhvillime pozitive. Pandemia i ka kufizuar disa gjëra, por shpresoj se së shpejti do të kalojë edhe kjo...

Si është të jesh inxhinier dhe boksier?

- Të jesh inxhinier dhe boksier është shumë e çuditshme, jo e zakonshme, meqë boksierët akuzohen nga njerëzit si jo shumë inteligjent.

Personalisht, njerëzve u dëshmoj të kundërtën, që mund të jenë studentë e profesionistë të dalluar dhe boksierë. Madje, të jesh boksier duhet të jesh shumë i zgjuar dhe i matur.

Gjithsesi, mua më pëlqen shumë puna inxhinierit i makinerisë, sepse duhet të jesh tejet preciz dhe të analizosh me kujdes çdo gjë.

Prandaj, më pëlqen balancimi i dy drejtimeve: inxhinier dhe boksier. Andaj, për titullin dhe stilin e boksit që kam, më thërrasin "The fighting engineer Maliaq".

Po, jeta private?

- Jam i martuar me Ofeljen. Prej kohësh jetojmë bashkë me prindërit dhe djemtë e mi në Zvicër. Kemi shumë harmoni dhe dashuri familjare, për çka jam krenar e i lumtur.

Si ta e përmbyllim këtë bisedë?

- I falënderoj të gjithë për mbështetje, duke i porositur që ta mbështesim njëri-tjetrin, të më mbështesin edhe mua në meçet e ardhshme, qoftë duke ardhur për t'më parë, apo duke më sponsorizuar.

Dhe, vetëm kështu ecim përpara...

N. Neziri



Ku ndodhet “Mulliri i Skënderbeut”?

Ndër banorë të zonës së Kurbinit, për “Mullirin e Skënderbeut”, fliten disa legjenda. Thuhet se në këtë mulli ka bluar Gjergj Kastrioti “Skënderbeu” me ushtrinë e tij, meqë ushtria osmane i kishte djegur të gjithë mullinjtë tjerë. E, ky mulli arriti të shpëtonte nga sulmet barbare, ngaqë ishte i fshehur mes malesh...

Pasi mbaron së bluari, kur Skënderbeu largohet, e bekon mullirin me fjalët: “Sa qofsh, blofsh! Edhe me një lot uji ti gur u rrotullofsh!”.

PSE “MULLIRI I SKËNDERBEUT” NUK NGRINË?

Një version tjetër i legjendës thotë se në një dimër të acartë, të gjithë

mullinjtë ishin ngrirë dhe nuk bluanin. Por, “Mulliri i Skënderbeut”, meqë është shumë afër me gurrën në Vinjoll, e cila furnizonte me ujë përroin e Hurdhazës (në dimër uji i burimeve nëntokësore është i ngrohtë), uji në këtë mulli nuk ishte ngrirë.

Mulliri Fall gjendet në jug të fshatit Gallatë në rrethin e Kurbinit. Ai është një objekt mjaft

interesant, i datuar që në shekullin XV.

Mulliri Fall, e që do të thotë “mulliri falë-falas”, kishte marrë këtë emërtim, sepse ata

që bluanin nuk kishin detyrim për mullirin qoftë në vlerë monetare qoftë në vlerë natyrore (misër apo grurë).

Mulliri ka qenë pronë e Kishës së Shën Prendës në atë fshat, sikurse del nga dokumentacioni historik dhe është përdorur rregullisht që nga koha kur në këtë zonë kryente luftimet kundër osmanëve Gjergj Kastrioti-Skënderbeu.

PSE ËSHTË LËNË NË HARRESË “MULLIRI I SKËNDERBEUT”?

Edhe pse ka qenë funksional deri para 30 vitesh, pasi për herë të fundit është restauruar në vitin 1974, moskujdesja dhe mosmirëmbajtja e këtij mulliri të veçantë, e ka lënë jashtë vëmendjes së mbrojtjes si monument kulture.

Edmond Brozi



+383 (0) 45 / 60 70 70 | info@brezovicahotel.com
+383 (0) 49 / 30 10 30 | www.brezovicahotel.com



I ndodhur në pjesën më të bukur në zemër të Brezovicës larg nga zhurma dhe nxitimi i qytetit, hoteli është i vendosur në një pjesë magjepsëse dhe të qetë të rrethuar nga malet e Sharrit dhe pranë Lumit Lepenc.

I ndërtuar me një arkitekturë të veçantë dhe magjepsëse, që të bën të ndjesh një qetësi shpirtërore, me një shërbim profesional që ruan standardet, e që në qendër të vëmendjes ka mysafirin, Hoteli posedon 72 dhoma të mobiluara me një stil luksoz modern, ku shumica e tyre ofrojnë pamje spektakolare mbi gjithë perllën e Brezovicës.

Këtu mysafirët do të ndihen komfort dhe të plotësuar. Hoteli ofron Restaurantin Gjethja, Opera Cafe Bar, Magnet Night Club, sallat e takimeve dhe konferencave si dhe Aquarius Spa Center.

Gjatë stinës së dimrit, mysafirët mund bëjnë skijim, ngjitje në male dhe aktivitete tjera dimërore.





Pse i burgosuri qeshte kur e dënuan me vdekje?

Tre të burgosur po bisedonin në dhomën e burgut. Njëri prej tyre sapo ishte kthyer nga gjykata ku kishte marrë shqiptimin - dënim me vdekje...

"Çka u bë? A shpëtove?", e pyetën shokët shokun, i cili sa qe kthyer nga gjykata në dhomën e burgut. "Jo more, nuk shpëtova. Më dënuan me vdekje!"

"Aiia, sa keq paskan bërë! Si ashtu ore?!"

"Por, ka edhe më keq!", ua ktheu ai.

"Çka mund të ketë më keq?!", pyetën të burgosurit shokun e tyre.

"Do të ishte edhe më keq sikur t'më vrisnin me plumb!"

Shokët iu ofruan edhe më afër dhe, duke tundur kokat para tij, në shenjë pohimi, i thanë:

"Po, edhe më keq do të ishte!"

"E, nëse më ngulin në hu gardhi edhe më keq do të ishte!", flet ai.

"E, si po të bien në mend, o burrë, gjithë këto fjalë, kur ti sapo je dënuar dhe po të punon koka si ora sergisuf?!", i thanë ata.

"Edhe juve, kur të dënoheni, do u punojë mendja si mua! E, sa të jeni të padënuar nuk ka nevojë t'u punojë truri më mirë se që jeni tash...", ua ktheu ai.

*

Kush hamamin ka vdekur te ju?! Shkon një burrë për krye-shëndosh në një fshat. Posa hyn në odë, ulet në krye të vendit dhe i shprehë ngushëllime burrit në ballë të oxhakut:

"Zoti u lashtë shëndosh për Hajdarin! Burri që ishte! Nuk ka pasur me të!", u thotë ai.

Burri, e që ishte në ballë të oxhakut, i thotë:

"Hajdari është ky, afër meje...", i thotë.

"Oh, bre, Zoti u lashtë shëndosh për Jasharin, se e paskam marr vesh gabim. Ka qenë burrë i burrave...", thotë tutje.

E, njeriu në ballë të oxhakut, ia kthen:

"Nuk ka vdekur as Jashari, këtu pari është diku..."

Atëherë mysafiri, i zënë ngushtë, ia kthen:

"Po kush hamamin ka vdekur, pra? Dikush e ka hangar këtu, por s'po di kush?!"

S. M.

Në cilin shqiptar u dashurua vajza e Sulltan Sulejmanit?

Si lindi dashuria e fshehtë e Sulltaneshës Mihrimah me arkitektin shqiptar, Sinanin?

Vajza e vetme e Sulltanit të madhërishtëm, Mihrimah, mbetet në hijen e nënës së saj të famshme, ish-sklaves Roksollana, e cila hyri në historinë e Turqisë si bashkëshortja e pabindur e Perandorisë Osmane.

I ati, Sulltan Sulejmani i madhërishtëm, e quajti "Mihrimah - Trëndafili i Perandorisë Osmane".

Por, Sulltaneshja e ndriçoi historinë e perandorisë si një personazh shumë i rëndësishëm, si një grua me një finesë të dukshme, tepër elegante dhe shumë e ndryshme nga nëna e saj.

Mihrimah, nga karakteri, nuk i ngjante as së ëmës e as të atit. Nuk trashëgoi nga Sulejmani ndjenjën e shfrenuar për pushtet, por as vazhdimin e së ëmës së saj.

SI E MARTUAN SULLTANESHËN 17 VJEÇE PA DËSHIRËN E SAJ?

Në vitin 1539 Mihrimah ishte 17 vjeçe dhe e ëma vendosi ta martojë me një burrë me diferencë moshe shumë të madhe. Ai ishte Rustem Pasha, të cilin ajo nuk e donte dhe nuk e deshi kurrë. Por, edhe pse me



Sulltaneshja Mihrimah

zemër të thyer, iu bind rregullave të repta të perandorisë.

Dhe, merrni me mend shtypjen që shkaktoi në shpirtin e një vajze të re martesë e imponuar?

Në atë kohë Bullgaria, si shumë shtete të tjera të botës, ishte pushtuar nga perandoria turke. Ishte viti 1558 kur vendi i quajtur Strellca, i famshëm për burimet e shumta me ujë mineral, u bë pronë e së bijës së Sulltanit të madhërishtëm, si dhuratë e tij personale për vajzën Mihrimah. Këtë fshat të bukur ia bëri Mihrimahi dhuratë Sulltani për martesë.

Ndërsa, Rustem pasha, si vakëf, përfitoi vendin e quajtur Arbanas (që ishte populluar me shqiptarë). Dhe, me të ardhurat e këtyre vakëfeve dhe vakëfeve të tjera, çifti filloi të merrej me bamirësi, si dhe me aktivitete kulturore.

Mihrimah porositi shqiptarin arkitekt Sinanin, që ishte arkitekti kryesor i perandorisë, të ndërtonte ndërtesa të veçanta. Sipas urdhrit të saj, ai ndërtoi xhaminë e quajtur "Mihrimah xhamija" në Odrin, "Iskile xhamija" në Stamboll dhe shumë imarete (ambiente bamirësie, strehëza ku shpërndahej ushqim falas për të varfrit dhe të pastrehët).

Arkitekt Sinani e ka ndërtuar edhe


xhaminë e madhe që gjendet në qendër të Sofjes.

SI ERDHI TE DASHURIA E SHQIPTARIT SINAN ME SULLTANESHËN MIHRIMAH?

Por, ndërkohë, një dashuri e zjarrtë ua pushtoi zemrat dy të rinjve. Arkitekt Sinani u dashurua marrëzisht me sulltaneshën Mihrimah, së cilës zjarri i dashurisë ia pushtoi zemrën dhe vetëm atëherë e bija e Roksollanës e kuptoi ndjenjën më të lartë të dashurisë.

Dhe, që ta përcillte sa më bukur ndjenjën e dashurisë, ajo iu përkushtua artit të pikturës mbi ujë. Jeta e saj ishte si pikturat që bënte mbi sipërfaqe – disa figura vetëm i prekte, të tjerat shkriheshin. Pikturat e saj ishin plot me dashuri për arkitekt Sinanin, por edhe me vuajtje e ndrydhje të shpirtit që pikonte lot.

Sepse, si ajo, por edhe arkitekt Sinani, e dinin se dashuria e tyre nuk mund të realizohej kurrë, sepse ishte e martuar me Rustem pashën dhe ceremonia e dasmës së saj kishte zgjatur me javë, si kurrë më parë në Perandorinë Osmane.



Arkitekt Sinani

Fjala është se shitësi di se çfarë duhani pi gruaja ime. Unë nuk jam duhanxhi dhe nuk e di çfarë cigare pi gruaja ime, edhe pse e shoh kah e bën tullug çdo ditë. Sepse, njeriu jeton duke i bërë qejf vetes, kështu, si gruaja ime...

Paska njerëz që po e njehkan gruan time më mirë se unë!

Po shkoja nga Prishtina në fshat dhe, kur arrita rrëzë "Vëternikut", më thërret gruaja në telefon e më thotë t'i blejë cigare.

"Ok", i thashë.

Por, tollovia në trafik nuk më la ta pyes se çfarë cigare t'i blej. Unë nuk jam duhanxhi dhe nuk di cila cigare ka shijen që e pëlqen gruaja.

Me të arritur në fshat, hyra në shitore.

"Ma jep një pako duhan!"

"Çfarë cigare?"

"Nuk di, harrova ta pyes gruan!"

"Për kë i ke?", më pyeti shitësi.

"Për gruan time", i thashë.

"Eh, more burrë, gruaja jote e di se ç'duhan pi... Ajo nuk e ndërron cigaren kurrë..."

"Shumë mirë, he burrë, ma hoqe një gajle, atëherë ma jep një pako!"

Dhe, pasi dola nga shitoret, një dreq

më hipi mbi krye... "Eh Sokol, Sokol... shitësi po e njehka gruan tënde më mirë se ti vetë! Jeton me vite me të, madje edhe ia blenë duhanin, kurse shitësi e di mirë se çfarë duhani pi ajo... Por, nuk është fajtor askush, sepse duhanxhinjtë ia dinë njëri - tjetrit tabiatin..." e solla në mendje. Dhe, nuk e zgjata më shumë e u largova nga dyqani, sepse nuk i dihet: shitësi mund të di edhe më shumë për gruan time...

MU KA BË KRYET "RAMADAN"!

Me të shkuar në shtëpi, ende pa ia dhënë cigaret, i thash gruas pse nuk më tregoi çfarë cigare me i ble. E ajo, si përherë, e ka përgjigjen në maje të gjuhës:

"Hajt ti se e di shitësi! Pse mërzhitesh ti për atë punë?! Gjithmonë blej te ai e ma ka mësuar tabiatin..."


"Ma hoqe edhe një gajle grua, i thash, se edhe ashtu jam rralluar pak e s'po mbaj mend shumë..."

"Eh, ti je rrallua, a?! Lëre atë punë, ti e di dreqi ku e ka strofullin!", më thotë duke qeshur.

"Për besë, kam filluar të bëhem budalla, i është prishur trurit kryet e memories, është bërë rrafsh, si thonë kah ne - është bërë "Ramadan"!

Me rëndësi, më nuk paskësja nevojë me të pyetur për llojin e duhanit që pi, se e paska regjistruar në kokën e vet shitësi dhe atij ende "kompjuteri" po i punuaka mirë...

Në popull thonë: "E di luga çka ka vegshi!"



★Che Bar Lounge 044 343 734
★Che Bar Marigona Residence 045 77 20 20
★Che Fox 044561562
★Che Bar Prizren 045774040
www.chebargroup.org
 /chebargroup



Pse investohet në vetura e rrugë, e jo në njerëz?

“Tullug po shkon në çdo anë!”, shpesh huhet në popull. Por, ai që e qon pluhurin shpesh edhe nuk duket nga pluhuri...

Shikoj te “Xhamia e Madhe” në Prishtinë disa libra e gjësende të tjera që shesin fetarët, njerëzit që në zhargonin popullor do ishin më të besuarit. Disa djem me mjekra, por nga sjellja shumë në nivel. Kërkoj një libërth (nuk di si ta quaj ndryshe, sepse në kohën e fëmijërisë sime njerëzit e quanin Musaf). Njëri prej atyre me mjekra më thotë:

“Nuk ka më asi libri që kërkon ti”.

“Pse, he burrë, nuk ka të tillë?”, e pyes unë.

“Është haram të barten ata, sepse njerëzit i bartin në vetura, i bartin në xhepa, hyjnë e dalin me të

çdo kund...”.

“Pse haram ta kesh me vete një Musaf?”, pyes veten.

Dhe, teksa largohem prej tij, eci mendueshëm, duke analizuar përgjigjet e djaloshtit me mjekër, pse qenka haram të mbahet një Musaf, apo një libërth që mund të ketë diçka kuranore.

Dhe, teksa eci, më bie në mend: Pse nuk e pyeta se cilit grup fetar i takon, sepse edhe te ne tash ka grupe...

Por, pas pak, sikur gjej zgjidhje: Më mirë të eci për në shtëpi e të mos nxjerr ndonjë bela të re, se kushedi...

E mora këtë shembull për të dalë

diku tjetër, te harami qeveritar apo i njerëzve të pushtetshëm, të cilët e fusin në përdorim paranë e shtetit për qëllime luksi.

Nuk investojnë për ilaçe, nuk investojnë për pacientët që ata të shërohen dhe të kthehen në shtëpi...

Investojnë në limuzina e në gjëra të tjera, por jo në shërim e as për popullatën sociale.

Investojnë në asfalt vend e pa vend, por jo në njerëz që kanë nevojë ta rikthejnë buzëqeshjen dhe shëndetin.

Keq, shumë keq...

Selim Rama





Nusja e martuar para syve të mi puthej me kamerierin!

Është nuse e re. Shpesh vjen në kafenenë “Al Porto”. Unë pi kafënë e mëngjesit aty, sepse lokalin e kam pranë. Dhe, teksa pija kafe me kolegun tim të redaksisë, nusja e re, e që e njoh edhe kur ka qenë vajzë, puthej me kamerierin!

Kolegu im, në shenjë kuraje, u tha: “Ju keni me qenë çifti më i mirë në Prishtinë. Jeni të bukur, të sjellshëm dhe nuk ka ku shkon ma mirë, veç ju vazhdoftë kështu me puthje e me të mira!”.

Me të mbaruar këtë urim, gruaja që puthej, ia ktheu kolegut tim:

“Unë këtë e kam shok dhe e kam veç me u puth me të, a për seriozisht e kam burrin, djalë aktori”.

“Edhe kështu u vazhdoftë!”, i uroi kolegu im.

GRUAJA E KUJT NDENJI TRI JAVË TE JARANI I VET?

Dhe, llaf pas llafi, në tavolinën tonë erdhi edhe i treti njeri. Nuk e kishim kushedi sa jaran, por njiheshim me të.

“Po si je hedi, kur erdhe se frik ke shkuar?”, e pyetëm.

“Oh, mos ardhsha ma! Erdha se një jaranit tim i ka kanë një kaçerr i keq. Gruaja i ka ikur te jarani i vet e më ka qar mua me ja kthye, sa nuk e ka marr vesh bota...”

Erdh burri që i ka ikur gruaja e më luti me

shkuar te ai jarani i gruas së tij dhe ia kreva punën. U morëm vesh me ja kthye gruan, por me kusht që kurrë mos me ia përmend se ajo e ka lënë burrin dhe ka ikur te tjetri. Erdhi gruaja e tij me mua dhe burri i saj para meje u betua se kurrë s’ka me bë fjalë atë ndodhi që kishin...

Por, s’mujta me u durua pa i thënë:

“Qysh bre me e kthye gruan që ka ndenjur disa javë te tjetri?”.

“Hajt, bre burrë, tash këqyre punën tënde e mos u merr më me neve!”, ma ktheu ai troç.

S. Rama

Prit me muaj e prit me vjet, i dashuri im në burg!



Jam 25 vjeçe dhe jetoj në Prizren. Po bëhen 5 vjet që jam njohur me një djalë. Në fillim nuk isha serioze me të dhe bëja shaka e talle-sha, por me kalimin e kohës marrëzisht u dashurova në të...

Unë nuk kam shumë shoqe, meqë jetoj në periferi të qytetit dhe nuk guxoj të ndaj diçka me një vajzë, sepse ajo, pastaj, do i tregoj krejt botës... Dhe, duke u nisur nga ky fakt, aq më pak mund të kem një shok. Andaj, kështu e kisha më të thjeshtë që t'i ndaja gjërat që më ndodhnin dhe hallet e mia me një të panjohur, me të cilin flisja vetëm në telefon...

SI U NJOHA ME LULIN NGA PRISHTINA?

Rastësisht në internet njoha Lulin nga Prishtina. Dhe, pas këmbënguljes së madhe të tij që të takoheshim pranova. Sajova disa gënjeshtra në shtëpi dhe shkova në Prishtinë për ta

takuar. Ishte djalë simpatik dhe më pëlqente të flisja me të. Më kuptonte dhe e kuptoja ose, të paktën, kështu thoshte ai.

Pas asaj dite më nuk takoheshim në Prishtinë, por ai vinte në Prizren dhe takimet tona bëheshin më të shpeshta, kurse mua më pëlqente gjithmonë e më shumë.

Në një nga takimet tona Luli më puthi. Isha shumë e lumtur, sepse kishte kohë që prisja të ndodhte diçka e tillë. U ktheva e lumtur në shtëpi dhe nga ajo ditë vetëm ëndërroja sesi do të ishte jeta ime me Lulin, se sa shumë e doja atë njeri dhe mendoja se më prisnin vetëm gjëra të bukura në të ardhmen...

Gjithsesi, takoheshim shpesh, derisa Luli kërkoi të bënim dashuri bashkë. Edhe pse kisha frikë dhe mendoja se pas kësaj gjërat mund të ndryshonin mes nesh, unë e doja Lulin dhe isha e gatshme të bëja gjithçka për të. Fjetëm bashkë dhe ai u tregua shumë i dashur me mua. Asgjë nga ato që më frikësonin nuk ndodhën...

RA NJË TELEFONATË DHE JETA IME MORI TEPOSHTËN!

Në një nga këto ditë, kur prisja me pa durim takimin e radhës me të, më vjen një telefonatë. Ai më tregon se do

shkojë pak ditë në Tiranë, e unë nuk duhet të mërzitesha se do të kthehej e do të martohej me mua.

Ishte hera e parë që e dëgjoja të fliste për martesë, por nuk munda të gëzohesha nga ky lajm, sepse më shqetësoi shumë fakti pse kishte vendosur papritur të shkonte atje...

Ngula këmbë t'më tregonte të vërtetën dhe ai më tha se ishte grindur me një shok dhe sherri kishte përfunduar keq...

Dhe, pas atyre fjalëve nuk di të tregoj se sa shumë u copëtua zemra ime... E, nëse nuk kthehet? Kjo edhe ishte frika ime më e madhe. Dhe, në fakt, kështu ndodhi...

Ai shkoi kinse në Tiranë dhe me muaj nuk m'u paraqit fare. Dhe, kur m'u paraqit, për çudi, më tha se paraqitej nga Italia dhe se ishte në burg!

ZOTI E DI KUR LIROHET NGA BURGU!

Ai ka dy vjet në burg dhe nuk dihet se kur do lirohet. Por, më lutet ta pres, sepse mund të lirohet së shpejti...

Në anën tjetër, mendoj se pas daljes së tij nga burgu gjërat mund të ndryshojnë, mendoj se ndoshta ai nuk do t'më dojë më kur të dalë, apo mendoj se edhe në mua mund të ndryshojnë ndjenjat për të...

E., Prizren



PARA

PAS



20 SEANCA

-13 KG

Qendrat e dobësimit 'Shkenda Dubova' janë ndër bizneset më të suksesshme të vitit. Duke filluar me një degë të vetme në Prishtinë, biznesi i Shkendës sharmante, ka kaluar kufijtë kosovar. Tani, qendrat e dobësimit gjenden edhe në Shqipëri, Gjermani dhe Zvicër, e njëkohësisht pritet që të hapen edhe nëpër vende të tjera të botës.

Gjithsesi, suksesi i tillë vjen si rezultat i punës së palodhshme të Shkendës dhe stafit të saj, mirëpo edhe i shumë storjeve të suksessit, të qindra klientëve të kënaqur.

Kush thotë që një femër nuk është e denjë për biznes?

Shkenda Dubova e dëshmon të kundërtën, duke qenë shembulli më i mirë i femrës kosovare të suksesshme.

Shumë mund të pyesin se si ndodhë i gjithë procesi i dobësimit tek këto qendra, me rezultate kaq

të dukshme tek klientët? Çdo klient fillon me seancat e shkrirjes së dhjamit, përmes aparaturave më moderne, që janë në përputhje edhe me standardet evropiane të teknologjisë së dobësimit.

Kështu, klienti së pari i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohen: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie, klienti humbet 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi, me një reduktim të perimetrit deri në 10 cm, për vetëm 10 seanca.

I gjithë ky proces ndodhë falë këtyre aparaturave, karakteristikat e të cilave do t'i shohim në vijim:

- Perfect Body-Tunnel Sauna - Është një aparaturë e teknologjisë së fundit, dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i së cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore e teknike, pa efekte anësore, e po ashtu, edhe kuruese për shumë sëmundje. Kjo aparaturë funksionon duke aktivizuar molekulat e ujit, që përmirësojnë thithjen e oksigjenit, qarkullimin e gjakut dhe nxisin metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta, kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epidermë), duke shpërbë grumbullimin e yndyrës të lokalizuar në bark, vithe dhe kofshe. Në mjekësi, IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve si: sëmundjet reumatike, sëmundjet degenerative të nyjeve, gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët), inflamacionet e hapësirave paranazale etj.
- Body Shape-Kabina e Shtrirë - Një tjetër pajisje që sjellë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Kjo aparaturë realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim dhe detoksifikimin e tyre, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet kryesore të kësaj aparature janë:

- Riaktivizon metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore, duke eliminuar kilogramët, dhe duke ofruar rimodelimin e formës trupore;
- Lehtëson dhimbjet nga patologji të ndryshme, si dhembjen e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin;
- Rritë qarkullimin e gjakut duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit, me elemente ushqyese;
- Tonifikim i thellë;
- Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ulë stresin;
- Përmirëson sistemin nervor;
- Zhdukë në mënyrë të ndjeshme celulitin duke eliminuar shtresat dhjamore;
- Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës;
- Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve;
- Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit;
- Lehtëson gjendjen e depresionit;
- Efekt analgjik;
- Lehtëson dhimbjen dhe përmirëson lëvizjet te personat që kanë sëmundje reumatike, etj.

• Sauna Tradicionale nga Druri i Pishës - Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë, ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi janë:

- Detoksifikim;
- Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ulë tensionin arterial;
- Humbje të peshës;
- Eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate;
- Relaksim muskolor, etj.

• Pajisja e Dobësimit Intensiv (Ultra Sonik) - Kjo pajisje funksionon përmes valëve sonike të frekuencës 40000Hz, të gjeneruar nga sonda. Pasi valët hyjnë në trupin e njeriut, gjenerohet efekt intensiv goditës në qelizat dhjamore, si dhe lëvizje ndërmjet qelizave dhjamore, të cilat në mënyrë efektive djegin energji, dhe kështu ndodhë tkurja e qelizave dhjamore. Ndërkohë, vibrimi i valëve sonike, shkakton ndikim intensiv midis qelizave, të cilat shpërthejnë menjëherë, duke zvogëluar numrin e qelizave yndyrore dhe arrijnë efektin e heqjes së dhjamit.

• Elektrostimulorët Muscular - Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm, përderisa jeni duke shkrirë dhjamin, përmes elektrostimulimit, tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qullët trupi, si dhe stimulohen muskujt dhe ngushtohet perimetri.

Cila grua refuzoi të bëhej dashnore e Enver Hoxhës?

Shkrimtari Ylljet Aliçka, në librin “Metamorfoza e një kryeqyteti”, tregon për momentin e tmerrshëm të ekzekutimit të 22 burrave dhe të një gruaje nga regjimi komunist i Enver Hoxhës, të cilët e mbrojtën gruan që nuk e dashuronte Enver Hoxhën.

22 burrat nuk ndenjen në rresht nga një përballë, siç e kërkonte rregullorja, por u bënë rreth, duke e mbrojtur me trupat e tyre një grua, i vetmi faj i

së cilës kishte qenë refuzimi i dashurisë së diktatorit Hoxha në kohën e rinisë së saj.


“Si në çdo fushë të jetës, edhe në atë të marrjes së jetës së armiqve, ndodhin parregullsi, kur rregulli nuk respektohet korrektësisht, siç ishte rasti i një ish-shefi të shtabit të ushtrisë, i cili, pasi u shpall armik, dha shpirt me mjaft vështirësi nga rrahja me purteka të trasha druri, në karrocërinë e një kamioni ushtarak.

Po si pasojë e shkeljes së rregullores, ndodhi që në një pushkatim pa gjyq, që iu bë 23 intelektualëve të shquar të kohës, 22 burra dhe një gruaje, pikërisht gjatë çastit kulmor të krejt procesit, atij të ekzekutimit, në respekt të të vetmes grua, të 22 burrat nuk ndenjen në rresht nga një përballë, siç e kërkonte rregullorja, por u bënë rreth, duke e mbrojtur me trupat e tyre gruan, i vetmi faj i

së cilës ishte refuzimi i dashurisë së Enver Hoxhës në rini të saj.

SI NDODHI VARROSJA PËR SË GJALLI E GRUAS QË NUK E DASHUROI ENVERIN?

Dhe, ndonëse e shpëtuan nga breshëria e plumbave, ashtu të lidhur me një tel të përbashkët me të gjithë të pushkatuarit, ata e tërhoqën pas vetes, për së gjalli, në gropën e përbashkët, hapur paraprakisht nga ata vetë. Si rrjedhojë, fshatarët e atyre zonave u lemerisën tek dëgjonin ca rënkime nga thellësia e tokës, për aq kohë sa i duhej një qenieje njerëzore të japë shpirt, mbuluar me dhe e bërë njësh me trupat e vdekur të 22 bashkëvetësve të saj”, thuhet në romanin e Ylljet Aliçkas “Metamorfoza e një kryeqyteti”.



Enver Hoxha dhe Aurelia Poselli
(gruaja që e refuzoi dashurinë e Enverit)



Kurrë s'më hiqet malli për ty!

Po e shkruaj pasi goja nuk ma nxë ta them: Më ka marrë malli për ty... Pikërisht kësaj dridhjeje që po ndjej tani i druhesha që nuk ja thosha vetes sa mall kam. E kam pranuar që s'të kam, por prapë s'e kuptoj si. Ishte shumë shpejt, ishte sikur uji që të derdhet nga duart e ti s'e kontrollon dot, sado mundohesh t'i mbyllësh gishtat dhe t'i puthitësh me njëri - tjetrin, uji ikën. Ashtu je edhe ti... Dhe, ndryshe nga uji i cili pastron, ti më ngacmon plagën që kam. Shumë të vështirë e kam kur kujtoj ndonjë të bërtitur që të kam drejtuar, më shtrëngohet zemra sa s'më del vendit nga ndjesia e keqe që s'të kam përballë e të të them: "Më fall!". Shoh duart e mia dhe, duke imagjinuar se janë të tuat, i shtrëngoj fort, por zgjohem shumë shpejt. Nëse do më pyesnin cila është dita jote më e keqe, do thosha:

Dita më e keqe për mua është çdo ditë kur kthehem në shtëpi dhe nuk të shoh ty. Çdo ditë kur veshët e mi bëhen gati të dëgjojnë të thirrurën tënde. Çdo ditë kur buzët e mia duan të puthin gushën tënde. Çdo ditë kur duart e mia duan të të përqafojnë dhe të të thonë frazën e përhershme që të bënte të buzëqeshje. Të paktën, ndihem mirë që ta kam shprehur me fjalë dashurinë time, pavarësisht sa e ke ndërjerë apo besuar atë. Dita më e keqe imja është çdo ditë kur zgjohem dhe nga goja bëhem gati të them: "Të dua shumë". Çdo ditë kur sytë e mi presin të dalësh që të të shoh qoftë edhe për pak. Çdo ditë kur pres t'më shkruash dhe t'më thuash: "Ku është dashuria ime më e madhja në jetë?" apo kur ta

dëgjoja zërin tënd që më bënte të dridhesha nga emocionet. Çdo ditë kur aq ëmbël më tingëllon kënga që më pate thënë ta dëgjonim bashkë. Çdo ditë imja është e keqe, pasi të gjitha këto kthehen në zhgënjim. Të ndjej shpesh, kur përjetoj një gëzim e them me vete ta ndaja me shpirtin tim... Të ndjej kur çdo zhgënjim më duhet ta përjetoj vetëm. Të ndjej kur ndonjëherë më duket sikur në shtëpi vërtitet era jote. Nuk di ku je tani, por e di që ti do vdesësh vetëm kur të vdes unë, e di që të kam me vete, çdo herë që marr frymë të ndjej dhe të dua. Të ndjej kur kujtoj çdo gjë që kam përjetuar me ty dhe më mungon çdo herë kur mendoj se çfarë do të përjetoj pa ty...

Jotja, Flora



Zgjidh një trëndafil dhe zbulo përparësitë tua në jetë...

Në foto janë gjashtë trëndafila të ndryshëm. Ata kanë ngjyra dhe forma të caktuara. Zgjidhni një nga trëndafilat, duke u nisur nga intuita juaj dhe zbuloni se cila është përparësia që keni në jetë...

NËSE KENI ZGJEDHUR NR. 1

Jeni person që thoni të vërtetën në sy. Jeni shumë i drejtpërdrejtë dhe besoni se drejtësia duhet të mbizotërojë, me siguri. Por, ky qëndrim shpesh nuk vlerësohet nga të tjerët, sepse jo të gjithë

janë të gatshëm të dëgjojnë nga ju atë që mendoni me të vërtetë dhe njerëzit ndihen në siklet.

NËSE KENI ZGJEDHUR NR. 2

Jeni person shumë i njohur. Nga natyra jeni shumë i lidhur me të dashurit tuaj, me fëmijët, me familjen. Ju i doni vaktet familjare, jeni i dashur, i mirë dhe shumë intuitiv. Rezulton se të tjerët nuk e vlerësojnë gjithmonë ndihmën dhe vëmendjen tuaj.

NËSE KENI ZGJEDHUR NR. 3

Jeni person shumë i ekuilibruar, që përpiqeni të shmangni konfliktet. Nuk jeni gati për çdo situatë, por i shmangni njerëzit që nuk kanë asgjë të mirë për të shtuar në jetën tuaj dhe largoheni shpejt nga ta.

Jeni gjithmonë në kërkim të paqes, të shoqërueshëm dhe të këndshëm.

NËSE KENI ZGJEDHUR NR. 4

Jeni person krijues dhe i talentuar. Keni një intuitë të zhvilluar.

NËSE KENI ZGJEDHUR NR. 5

Jeni person shumë privat, u pëlqen të jeni në qetësinë e një ambienti të këndshëm me njerëzit që doni. Jeni mësuar të mos u besoni njerëzve, keni frikë nga pjesa tjetër dhe nuk i lini të hyjnë në botën tuaj.

NËSE KENI ZGJEDHUR NR. 6

Jeni person aktiv, shumë i dobishëm dhe i vendosur për të arritur qëllimin që keni. Dashuria është ajo që drejton zemrën tuaj tani.



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE

Ilo Kovi, nga rrethi i Korçës, emigrant shqiptar në Boston të SHBA-ve, shpëtoi në fatkeqësinë e madhe të quajtur "Titanik". Por, nga të ngrirët ia prenë të dy këmbët.



Ndërmjet Anglisë e Nju-Jorkut u realizua një nga historitë më tragjike të njerëzimit. Ngjarja e përmasave të pazakonta përkujtohet çdo vit në mes të prillit në shtetet më të qytetëruara të botës.

Ndërsa, te ne, shqiptarët, pak të interesuar e dinë se natën e frikshme, fare pranë anglishtfolësve e të tjerëve, mes britmave të tmerit, panoramës tronditëse të zhytjes nën ujë të gjigantit më të madh të deteve, përpjekjeve të shpirtrave për mbijetesë, ka pasur edhe diçka shqiptare.

Pse ia prenë këmbët shqiptarit që shpëtoi në "Titanik"?

Një frymë njeriu, një zë, që mbase nuk ka shqiptuar asnjë fjalë në gjuhën e nënës, por që thuhet se ka klithur me gjuhën e dhimbjeve.

Për ndodhinë e tij në "Titanik", ka treguar i biri i Ilos, Dhimitër Deti, 80-vjeçar, në prani të shoqes Parashqevi dhe bijës, Donika.

SI U GJEND NË ANIJEN MË TË FAMSHME TË TË GJITHA KOHËVE VITHKUQARI ILO KOVI?

- Im atë quhej Ilo Kovi. Në atë kohë ishte 22-vjeçar. Gjendej në kurbet, në Boston të SHBA-ve. Dhe, me të dëgjuar për anijen gjigante, u nis për në Angli, sepse ishte kurioz të shihte anijen e famshme.

Në momentet që anija gjigante, pas përplasjes me ajsbergun, kishte filluar të mbushej me ujë e marinarët po zbrisnin barkat e para me gra dhe fëmijë, kryesisht të klasit të parë, Ilua kishte ndihmuar të sistemohej në varkë një familje. Në çastin që varka po ulej, Ilua ishte kapur pas njërit prej litarëve të saj të lëshimit.

Në këtë kohë ai është qëlluar me lopata e sende të tjera të forta nga marinarët, duke rënë në det. Me të rënë në kontakt me ujin e ftohtë, ai arrin të kapet pas barkës së sapolëshuar. Pak çaste më vonë tenton të hipë në varkë, por marinarët e qëllojnë me lopata ku mundën. Ata kishin urdhër që të mos rrezikohej mbytja e varkave, qoftë nga mbipesha, qoftë nga shkaqe të tjera.

Ilon e kanë goditur disa herë me lopa-

tat e drunjta pa mëshirë në këmbë në momentet kur kapej dhe tentonte të shalonte anën e varkës për t'u futur në brendësi të saj.

Porse në çastet që marinarët arrinin ta prapsnin, duke e hedhur sërish në det, barka anohej dhe tronditej. E kishin gjakosur duke e goditur, pasi ai ishte përpjekur disa herë radhazi të hipte, pa i shkaputur duart nga varka. Dikur njëra nga gratë, pikërisht ajo që Ilua e ndihmoi të sistemohej në barkë, këmbëngul ta merrnin edhe atë, duke protestuar e thënë se ai kishte rrezik t'i mbyste të gjithë.

Ilo ishte i ri dhe i fuqishëm dhe duke përdorur këmbët si lopata, arriti ta largonte varkën nga "Titaniku" që fundosej.

Më pas, këmbët, shkak i ujit akull, iu gangrenizuan dhe doktorët ia prenë njëra pas tjetrës.

1523 UDHËTARË VDIQËN NGA PËRMBYSJA E "TITANIKUT"

Titaniku ishte anija më e madhe e kohës së vet. U deshën 5 vjet për ta ndërtuar. Ajo nisi udhëtimin e saj të parë më 10 prill 1912, nga Southampton i Anglisë, me 2228 njerëz në bord, përfshirë ekuipazhin, por nuk arriti kurrë në destinacion, që ishte Nju-Jorku. "Titaniku" u përplas me një ajsberg në afërsi të Nevfoundlandit, pesë ditë më pas, më 14 prill 1912. U mbytën dhe humbën 1523 njerëz dhe mbijetuan vetëm 705, në mesin e të cilëve edhe Ilo Kovi, shqiptari i vetëm që ndodhej në "Titanik".



Cilat shenja të zodiakut nuk përkulën para askujt?

Këto shenja demonstrojnë guxim mbi mesataren përballë fatkeqësive dhe zgjedhjeve të vështira. Ato ndihen mirë në çdo rol dhe shkëlqejnë në momentet më të errëta.

DASHI

Të lindurit nën shenjën e Dashit janë udhëheqës të shquar. Liria për të shkuar në rrugën e tyre dhe fryma aventureske sigurojnë një themel optimal për vendimarrje. Fakti se ata janë të përqendruar dhe kanë një personalitet intensiv, i kuali-

fikon si njerëzit më interesantë për t'u lidhur. Me një Dash pranë nuk do i përjetoni dy ditë njësoj.

GAFORRJA

Të lindurit e kësaj shenje kanë personalitet të fortë dhe sjellje dominante në punë dhe jetën personale. Besimi që ata kanë në aktivitetet e tyre të përditshme, i bën shokë të besueshëm dhe partnerë besnikë dhe të dashur. Një cilësi tjetër, e që i veçon ata, është vullneti që ata shfaqin në kohë sfidash të mëdha. Është një shenjë që shquhet për marrjen e vendimit të duhur, kur janë nën presion.

LUANI

Luani është një nga personalitetet më të forta të zodiakut. Nuk ka asnjë shans që ai të jetë personi që merr lehtësisht porosi. Përkundrazi, Luani shkëlqen në komandën e veprimeve.

Pozitiviteti që buron nxit, gjithashtu, këtë imazh të një udhëheqësi natyral. Një pikë tjetër që e dallon është guximi. Me energji dhe prirje, ai është një person që i pëlqen të jetë qendra e komandës; diçka ushqen kotësinë që ju jep edhe kënaqësi.

AKREPI

Akrepi është një nga shenjat më të diskutueshme të zodiakut dhe, gjithashtu, më të guximshme. Akrepi nuk kursen asnjë përpjekje për të mbrojtur veten, gjithmonë me shumë energji dhe besim. Ata qëndrojnë në prag të fatkeqësisë dhe janë jashtëzakonisht të përqendruar.

Këta njerëz ndalojnë vetëm kur marrin atë që kanë imagjinuar. Një cilësi tjetër e shkëlqyeshme e Akrepit është që marrin në konsideratë një angazhim për atë që është moralisht e drejtë dhe e gabuar.

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depressive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Çka do të ndodhë me ne dhe a do të ribashkohemi?

Përshëndetje, jam një grua, 39-vjeçare, kam probleme me burrë. Jetojmë jashtë Kosovës, kemi fëmijë. Ka një vit që jemi ndarë dhe jemi në proces gjyqësor. Unë, edhe pse jam duke e pritur ndarjen me letra, ai, de fakto, nuk më lë të qetë! Çdo ditë më bën dhunë psikike, kur i merr fëmijët apo kur i sjellë... Dhe, jam lodhur prej tij... Nuk di çka do të ndodhë me ne dhe a do të ribashkohemi, apo do të vazhdojë jeta jonë, ashtu siç ishte, me shumë defekte?

"Mëngjesi"

Përgjigje:

Bashkëshortësia juaj ka marrë tatëpjetën për shkak të pabarazisë së të drejtave njerëzore. Ai e ka llogaritur veten në mënyrë kanunore, si burrë që ka të drejtën absolute mbi ty dhe ti e ke pranuar variantin më të keq të mundshëm, e ku ti je gjithnjë viktimë, por që nuk guxon të ankohesh...

Dhe, kjo sjellje e tij, me kohë, të ka ardhur në maje të hundës. Reagimi yt ka qenë "skandaloz", sepse ai është mësuar të jesh e nënshtruar... Ai ka bindjen se ti po e largon nga jeta e tij, se ke gjetur dikë tjetër dhe për këtë arsye të ofendon, të shanë, por përdor edhe dhunë ndaj teje! Për sjelljen e tij, ashtu qysh e ke shpjeguar ti, janë organet shtetërore që merren me to dhe ti duhesh ta denoncosh. Por, në kuptimin tjetër se çka do të ndodhë mes jush, unë shoh ndarje për një tre vjet, pastaj ribashkim.

Kam bërë një gabim, andaj burri me mua më nuk do asgjë!

Jam një zonjë nga Ferizaj, e që jetoj në Prishtinë. E kam bërë një gabim dhe dua të dal nga situata që po vuaj. E kam tradhtuar burrin dhe prej asaj kohe ai nuk fle me mua. Flemë të ndarë në një dhomë, por pa pasur asgjë që një vit.

Si të veproj tani? Ç'të bëj që të rinisi një jetë të re?

Pa shifër

Përgjigje:

Nëse flasim drejt, nuk është fjala për një tradhti, por për shumë tradhti. Personi për të cilin po flasim është shoku i burrit tënd dhe kjo zor është përbirë nga bashkëshorti yt. Meqë flini në një dhomë, unë besoj se keni për ta thyer "arrën" dhe mund të rifilloni një fazë të re dashurie bashkëshortore.

A do t'i gjej prindërit e mi?

Jam 20-vjeçare. Kam kuptuar se prindërit që i kam nuk janë prindërit e mi të vërtetë, edhe pse nuk mund të ankojem për asgjë. I kam të gjitha dhe më duan e më çmojnë shumë. Unë vdes për ta... Fillimisht, çdo detaj e kam mësuar nga shoqja ime e ngushtë, me të cilën jam shoqëruar në shkollë e çdo kund tjetër...

Dhe, një ditë iu afrova nënës dhe i thash se kam parë ëndërr që nuk jam vajza e saj. Ajo u mundua të bëhet e fortë, por e pash që u godit rëndë dhe e ndali këtë temë, duke më thënë mos u merr me ëndrra...

Unë dua të jetoj me këta që më kanë rritur, por edhe dua t'i njoh prindërit e mi...

"E"

Përgjigje:

Vërtet, nuk i di të gjitha procedurat ligjore, por mendoj se është një rrugë ligjore, përmes

së cilës ti mund ta realizosh të drejtën tënde për të ditur më shumë për këtë problem. Më së miri do të ishte që vetë t'i drejtohesh Qendrës Sociale, sektorit për këtë problematikë dhe të kërkosht të dish për prindërit tu gjenetik. Besoj se është e drejta jote e pamohueshme të kërkosht të jesh e informuar për nënën dhe babanë tënd: kush janë dhe ku janë... Nuk ke nevojë për shqetësime, as për t'i zmadhuar gjërat, sepse, para së gjithash, nuk e di të vërtetën pse je braktisur prej tyre, pastaj nuk di ku jeton nëna dhe me kënd jeton, a ka fëmijë të tjerë dhe a di burri i saj se ajo e ka pasur edhe një vajzë, që e ka lënë... Dhe, krejt këto gjëra duhet t'i kuptosh gradualisht, që të mos hapësh plagë të reja... Megjithatë, Qendra Sociale do t'i tregojë të drejtat tua se çka ke të drejtë të kërkosht dhe ku është kufiri. Sepse, kjo është situatë e ndjeshme shumë, prandaj do maturi...

Burri punon për të tjerët...

Përhëndetje, jam nënë dhe dua të ndaj një hall me ju, për të marrë një përgjigje të drejtë, meqë po frikësohem mos po gabohem ndaj burrit. Burri im është i dhënë shumë pas familjes së vet dhe punon më shumë për vëllezërit sesa për vete. Ne kemi fëmijë, e që duhet t'i stabilizojmë dhe të kemi diçka për ta, por burri nuk ndihet ndaj tyre

i kujdesshëm, pasi që sytë i shkojnë më shumë kah familja dhe vëllezërit... A është e drejtë që të heqin fëmija e mi, ndërsa ai t'u jep të tjerëve, e që as nuk e thirrin ndonjëherë, as nuk e duan, as nuk pyesin për të?
"Pa shifër"

Përgjigje:

Ke të drejtë kur thua se fëmijët duhet ta kenë përkujdesjen e burrit më shumë sesa të tjerët nga familja e gjerë. Ke të drejtë të kërkosht, së pari, të jenë fëmija para të mëdhenjve. T'u ndihmojë të tjerëve do të ishte normale pasi t'i kryejë obligimet ndaj fëmijëve, së pari... Ju, megjithatë, duhet të gjeni mirëkuptim, që ta ktheni kah fëmija dhe mos të kërkonin në mënyrë klasike ta harrojnë familjen, prindërit, vëllezërit, motrat, sepse jeta është një rrotë qerreje, e cila sillet, por ka raste edhe kur ngecë në baltë. Sot keni, nesër mund të jetë ndryshe... Dhe, kur nuk keni, tek atëherë e kuptoni mëshirën apo ndihmën e të tjerëve sa ka rëndësi...

Pse kam bindje negative ndaj vetes?

Zonjë, jam 34-vjeçare, e pamartuar. Kam pasur një fejesë që ka dështuar dhe prej atëherë kam shumë bindje negative ndaj njerëzve, madje edhe ndaj vetvetes. Shpesh mendoj pse jam e tillë dhe pse kam kaq shumë energji negative ndaj vetvetes....

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: "Kosovarja", fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

A kam magji, sepse kam mbetur e pafat dhe kur do t'më buzëqesh fati?

"Pakënaqësia"

Përgjigje:

Njeriu që posedon energji të tilla negative, kur e sheh veten, zakonisht, në binarë që qojnë tjetër kah prej qëllimit dhe dëshirës, nga dëshpërimi shpeshherë bëhet edhe misterioz.

Ti je shumë e mbyllur dhe moskomunikimi i problemeve me të tjerë ka bërë që t'i ndash gjërat e rënda vetëm me vet-veten. E, kjo është irracionale me karakterin e njeriut si qenie shoqërore.

Kur ke frikë të hapësh, bindjet tua mund ta shkatërrojnë botën e brendshme. Dukuritë e jashtme të botës jetësore duhet të ekuilibrohen me botën e brendshme dhe ky ekuilibrim nuk mund të bëhet pa i komunikuar problemet, sepse komunikimi sjell zgjidhje dhe ide që e bëjnë problemin më të vogël. Ne jetojmë në riciklime të negativiteteve. Unë shoh se ti nuk e ke ndarë asnjë brengë me ndokënd dhe se nuk është vonë të ndryshosh në këtë pikëpamje, sepse ndryshimi do ta sjellë edhe fatin...

Shoh se vitin që vjen do të martoresh, më saktë kah mesi i gushtit.



SHERWOOD

Resorts and Hotels

Feel the Legend

**SHERWOOD
EXCLUSIVE KEMER**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
EXCLUSIVE LARA**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
DREAMS RESORT**
BELEK / ANTALYA

**TUI BLUE
BELEK**
BELEK / ANTALYA

**SHERWOOD
SUITES RESORT**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
GREENWOOD RESORT**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
PRIZE HOTEL**
LARA / ANTALYA

+90 242 444 88 07
www.sherwoodhotels.com.tr

